



Financuar nga
Bashkimi Evropian

unicef 
for every child

ZBATIMI I MASAVE TË DIVERSITETIT

NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR



Vlerësimi i zbatimit të masave të diversitetit në sistemin e drejtësisë për të mitur është zhvilluar në kuadër të projektit *Mbrojtja e fëmijëve të cënueshëm në Kosovë*, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe implementohet nga UNICEF në Kosovë, në bashkëpunim me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF.

Mohim përgjegjësie:

Pikëpamjet e shprehura në këtë vlerësim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimet zyrtare të KOMF, UNICEF, dhe BE apo ndonjë institucioni tjetër të përfshirë. Është bërë çdo përpjekje për të siguruar saktësinë e informacionit të paraqitur, bazuar në të dhënat dhe materialet e disponueshme në kohën e hartimit.

Përgatitur nga:

Z. Ardian Klaiqi, Ekspert Ligjor

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I: SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME	6
1.1. Përmbledhje ekzekutive	7
1.2. Hyrje	8
1.3. Metodologjia	11
1.4. Kufizimet dhe konsideratat etike	15
1.5. Drejtësi për të mitur apo drejtësi për fëmijë?	16
1.6. Numri i të miturve në konflikt me ligjin	20
.....	
KAPITULLI II: MASAT E DIVERSITETIT	28
2.1. Baza ligjore dhe institucionet e mandatuara	29
2.2. Qëllimi, llojet dhe risitë	33
2.3. Shqiptimi i masave	36
2.4. Format dhe mënyrat e shqiptimit	38
.....	
KAPITULLI III: PËRMBYLLJE	42
3.1. Të gjeturat e vlerësimit	43
3.1.1. Të gjeturat për secilën masë veçmas	43
3.1.2. Të gjeturat e përmbledhura	61
3.2. Konkluzion	66
3.3. Rekomandime	67
.....	
IV. SHTOJCA	71
4.1. Burimet e referencave	71
4.2. Lista e profesionistëve të intervistuar, takimet e zhvilluara dhe grupet e fokusit	75
4.3. Përkufizime	78
.....	

SHKURTESAT

▪ ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
▪ BE	Bashkimi Evropian
▪ KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
▪ KDFKB	Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i Kombeve të Bashkuara
▪ KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
▪ KP	Kodi Penal
▪ KPK	Kodi i Procedurës Penale
▪ KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
▪ KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
▪ KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
▪ LMF	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
▪ MD	Ministria e Drejtësisë
▪ OAK	Oda Avokatëve të Kosovës
▪ OJQ	Organizata jo-Qeveritare
▪ OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
▪ QPS	Qendra për Punë Sociale
▪ SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
▪ UNICEF	Fondi Emergjent i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
▪ ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

KAPITULLI I:

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Përmbledhje ekzekutive

Ndëshkimi dhe veçanërisht burgosja e të miturve është vlerësuar historikisht si e dëmshme për zhvillimin e tyre psikologjik dhe fizik, andaj në nivel ndërkombëtar dhe në shumë shtete është punuar për të zhvilluar alternativat kundruall ndëshkimit dhe dënimit me burg, në funksion të risocializimit dhe ri integritit të miturve në familje dhe shoqëri.

Në këtë drejtim, Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe standardet ndërkombëtare e regjionale kanë nxitur zhvillimin e sistemeve që vendosin theksin te drejtësia për të mitur, e cila është miqësore dhe humane karshi ndërhyrjes institucionale ndaj të miturve në konflikt me ligjin. E reflektuar në kornizën ligjore të Kosovës përmes Ligjit për të Mitur (2004), Kodit të Drejtësisë për të Mitur (2010) dhe versionit të përditësuar që është në fuqi nga viti 2018, kjo qasje e re ka për qëllim zëvendësimin e ndëshkimit me masa edukative, mbështetëse dhe të individualizuara, ku masat e diversitetit përbëjnë formulën dhe zgjidhjen kyçe për shmangien e procedurës penale formale dhe ndalimin e institucionalizimit të panevojshëm të të miturve.

Ky vlerësim ofron një analizë të thelluar të zbatimit të masave të diversitetit në praktikën e drejtësisë për të mitur në Kosovë, përmes shqyrtimit të kuadrit ligjor, strukturës institucionale, praktikave ekzistuese dhe sfidave kryesore në terren. Të gjeturat e vlerësimit nxjerrin në pah një tendencë shqetësuese të rënies së vazhdueshme në përdorimin e masave të diversitetit, gjë që bie ndesh me frymën dhe objektivat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Mospërputhjet në nivel të Prokurorive Themelore, mungesa e qartësisë në interpretimin e dispozitave ligjore, dhe moszbatimi i masave të reja të përfshira në Kod, dëshmojnë për një zbatim të fragmentuar dhe jo të qëndrueshëm të këtyre masave. Për më tepër, ekziston një keqkuptim i theksuar ndërmjet masave të ndërmjetësimit dhe atyre të tjera të diversitetit, si dhe mungesë referimesh për ndërmjetësim për shkak të perceptimit të gabuar mbi kriteret profesionale të ndërmjetësve, ndonëse KDM nuk kërkon licencim formal por vetëm trajnim të certifikuar.

Këto mangësi jo vetëm që zbehin efikasitetin e drejtësisë për të mitur dhe objektivat e saj rehabilituese, por gjithashtu rrezikojnë të drejtat themelore të të miturve dhe mbrojtjen nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga përfshirja

në sistemin penal. Në këtë kontekst, raporti thekson nevojën për ndërhyrje strategjike për të fuqizuar kapacitetet institucionale, për të harmonizuar qasjen ndërinstitucionale, për të rritur nivelin e njohurive praktike dhe juridike të profesionistëve të drejtësisë dhe për të promovuar një kulturë të drejtësisë restauruese përmes trajnimeve, udhëzimeve standarde dhe mbështetjes së vazhdueshme teknike nga partnerët zhvillimorë. Rekomandimet konkrete të nxjerra nga vlerësimi synojnë që të përshpejtojnë zbatimin e duhur dhe të drejtë të masave të diversitetit, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së fëmijëve në sistemin e drejtësisë.

1.2. Hyrje

Në Kosovë, rreth 38% e popullatës është nën moshën 24 vjeçare, ndërsa afërsisht 28% e popullatës është e përbërë nga fëmijë nën moshën 18 vjeçare¹. Kjo përqindje e konsiderueshme e të miturve dhe të rinjve ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e shoqërisë kosovare, duke i dhënë një rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe garantimit të kushteve që mundësojnë zhvillimin e plotë të potencialeve të tyre. Si pasojë e këtij dinamizmi demografik, qëndrimi dhe trajtimi i fëmijëve dhe të miturve, veçanërisht ata që janë në konflikt me ligjin, paraqet një prioritet të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës.

Kosova ka ndërmarrë një angazhim të vazhdueshëm për të siguruar një kornizë ligjore dhe politike që e mbështet dhe respekton të drejtat e fëmijëve dhe të miturve, duke i trajtuar ata si bartës të të drejtave njerëzore dhe si pjesëmarrës aktivë në shoqëri. Në këtë kuadër, të drejtat e fëmijëve dhe të miturve janë të njohura si një aspekt integral i të drejtave të njeriut. Fëmijët, si subjekte të drejtave, gëzojnë jo vetëm të drejta universale që i takojnë çdo individ, por edhe të drejta specifike, që janë të përshtatura për nevoja dhe kushte të veçanta të moshës së tyre.

Ky trajtim specifik ka për qëllim jo vetëm mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit të fëmijëve, por edhe krijimin e mundësive që ata të zhvillohen dhe rriten sikur bashkëmoshatarët e tyre në botë. I gjithë ky proces është i bazuar në parimin e interesit më të mirë për fëmijët, që siguron mundësi për zhvillim të shëndetshëm

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe ekonomive familjare 2024.

dhe paqësor në përputhje me nevojat dhe kërkesat e moshës dhe situatës së tyre. Përshtatja e politikave dhe praktikave të drejta që përfshijnë këtë grup të rëndësishëm të shoqërisë është thelbësore për të ndihmuar në krijimin e kushteve që do të mundësojnë arritjen e qëllimeve të tilla.

Duke qenë se fëmijët dhe të miturit varen nga kujdesi dhe mbikëqyrja e prindërve, kujdestarëve dhe institucioneve për të siguruar jetën dhe zhvillimin e tyre, çdo ndërhyrje ligjore dhe procedural ka një ndikim të thellë dhe të drejtpërdrejtë në jetën e këtij grupi. Kjo e bën të domosdoshëm trajtimin e çdo veprimi që mund të ketë ndikim mbi ta, qoftë në aspektin pozitiv apo negativ, përmes një qasjeje të kujdesshme dhe të përgjegjshme.

Në këtë kontekst, për të siguruar një trajtim të duhur dhe mbrojtje të vazhdueshme për fëmijët dhe të miturit që janë në konflikt me ligjin, është krijuar sistemi i drejtësisë për të mitur. Ky sistem është ndërtuar me qëllimin për të ofruar një qasje të integruar, të ndjeshme dhe të përshtatshme për moshën e fëmijëve, duke e shmangur kriminalizimin e tyre të pashmangshëm dhe duke ofruar mundësi rehabilitimi dhe ri integrimi social. Pjesë e këtij sistemi janë masat e diversitetit apo (masat e shmangies) që ofrojnë mundësi alternative për të trajtuar të miturit jashtë proceseve të gjyqësorit të zakonshëm dhe për t'i ndihmuar ata të kthehen në rrugën e zhvillimit të shëndetshëm.

Gjatë viteve të fundit, në Kosovë janë miratuar një numër i konsiderueshëm ligjesh të reja dhe janë themeluar, ose janë në proces themelimi i institucioneve që kanë përgjegjësi specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të fëmijëve si kryerës të veprave penale. Vend shumë thelbësor dhe të rëndësishëm në këto ndryshime zënë edhe masat e diversitetit. Në këtë kontekst, realizimi i këtij vlerësimi konsiderohet i domosdoshëm pikërisht në këtë periudhë, me qëllim të analizimit të funksionimit aktual të sistemit dhe të vlerësimit të shkallës së zbatimit të ligjeve dhe politikave ekzistuese në praktikë, në raport me masat e diversitetit.

Përveç zhvillimeve të shumta ligjore dhe institucionale që kanë ndodhur vitet e fundit, realizimi i këtij vlerësimi bëhet edhe më i rëndësishëm në kontekstin e ndryshimeve të konstatuara në raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, të cilat japin një pamje të përzier mbi ecurinë e drejtësisë për të mitur në Kosovë.

Në njërën anë, disa raporte theksojnë progresin e rëndësishëm të arritur ndër vite. Për shembull, vlerësimi i përbashkët i BE-së dhe UNICEF-it mbi programet mbështetëse të zbatuara gjatë viteve 2007–2018, konstaton: *“Rezultatet e arritura gjatë zbatimit të aksionit dhe arritjet që mund të vërehen tashmë, vërtet konfirmojnë vlerën e mbështetjes së ofruar nga BE për zhvillimin e një sistemi të drejtësisë për të mitur në Kosovë dhe rëndësinë e tij në kuadër të mekanizmit të përgjithshëm të aksionit me qëllim promovimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.”*

Në të njëjtën linjë, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2016 nënvizon: *“Kodi i Drejtësisë për të Mitur është i udhëhequr nga parimi i ‘interetit më të mirë të fëmijës’, ashtu siç është përcaktuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Themelet e sistemit të drejtësisë për të mitur janë vënë, dhe departamentet për të mitur janë krijuar në të gjitha Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore.”*

Megjithatë, në anën tjetër, raportet e KOMF (Karta e Vlerësimit) të realizuara gjatë viteve 2023 respektivisht 2024, vlerësojnë sistemin e drejtësisë për të mitur me notën 2, që paraqet një vlerësim shumë të dobët, duke theksuar se: *“Në Kosovë vazhdojnë të mungojnë pothuajse tërësisht shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të mbeten me kapacitete shumë të kufizuara për të punuar me këta fëmijë e po ashtu edhe sektori joqeveritar ka mungesë të theksuar në ofrimin e këtyre shërbimeve. Themelimi i qendrave apo shtëpive të specializuara për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, nën moshën e përgjegjësisë penale është jashtëzakonisht i domosdoshëm. Institucionet duhet të konsiderojnë mundësinë e ndarjes së dy Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës për nevojat e kësaj kategorie, nga shtatë shtëpitë e parapara në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Masat e diversitetit, të cilat janë thelbësore në nxitjen e rehabilitimit dhe re integritit të miturve, vazhdojnë të zbatohen minimalisht, përkundër faktit se ato janë dyfishuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.”²*

Në lidhje me zbatimin praktik të këtyre reformave, raporti i KOMF konstaton regresin në fushën e drejtësisë për të mitur, me theks të veçantë në mos përdorimin

² Shkalla e notimit me 2 është nota e parafundit në shkallët e notimit për të gjithë kartën e vlerësimit dhe paraqet notimin e dobët, dhe ka këtë karakter: *‘institucionet deklarojnë se janë të përkushtuar në zgjidhjen e problemeve, megjithatë, nuk sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, dhe ka mungesë të veprimeve reale dhe të qëndrueshme. Edhe pse institucionet kanë shprehur vullnetin për të adresuar çështjet, hapat e ndërmarrë janë minimalë, sporadikë, dhe/ose jo konsistence, pa sjellë rezultate të dukshme.*

e duhur të masave të diversitetit. Ky raport gjithashtu thekson boshllëqet në zbatueshmërinë e ligjeve, mungesën e kapaciteteve institucionale dhe nevojën për përmirësim të koordinimit ndërinstitucional.

Krahasimi i këtyre vlerësimeve tregon një mospërputhje mes zhvillimeve ligjore dhe strukturave të ngritura, dhe zbatimit efektiv të tyre në praktikë. Për rrjedhojë, është thelbësore të realizohet një vlerësim gjithëpërfshirës për të identifikuar sfidat ekzistuese, për të matur ndikimin e mekanizmave të tanishëm dhe për të orientuar veprimet e ardhshme drejt përmirësimit të sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

Qëllimi i këtij vlerësimi është të analizojë dhe vlerësojë efektivitetin e zbatimit të ligjeve dhe politikave për drejtësinë për të mitur në Kosovë, me fokus të veçantë në masat e diversitetit dhe aplikimin e tyre në praktikë. Ky vlerësim ka për qëllim të identifikojë sfidat ekzistuese në përdorimin e këtyre masave, të cilat janë thelbësore për rehabilitimin dhe re integrimin e të miturve në shoqëri, si dhe të analizojë nevojën për forcimin e mekanizmave ekzistues për të siguruar që masat e diversitetit të zbatohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e fëmijëve.

1.3. Metodologjia

Përgjatë realizimit të vlerësimit është përdorur një qasje e kombinuar e metodave cilësore dhe sasore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informacioneve, përfshirë rishikimin e literaturës, intervistat gjysmë të strukturuar dhe diskutimet në fokus grupe përmes punëtorive.

■ *Të dhëna statistikore dhe trendet*

Pjesë e rëndësishme e këtij vlerësimi ishte mbledhja dhe analizimi i të dhënave statistikore të siguruar nga Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues, dhe Prokuroritë lidhur me të miturit në konflikt me ligjin. Vëmendje e veçantë i është kushtuar statistikave që ndërlidhen me përdorimin e masave të diversitetit. Përmes analizës së trendeve krahasuese ndër vite, synohet të vlerësohet jo vetëm zhvillimi institucional dhe ligjor në këtë fushë, por edhe ndikimi praktik i tyre në jetën dhe mirëqenien e të miturve që përballen me sistemin e drejtësisë. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për identifikimin e boshllëqeve dhe për orientimin

e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme në funksion të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

■ **Rishikimi i literaturës**

Analiza dhe rishikimi i dokumenteve ka qenë një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të këtij vlerësimi. Janë konsultuar dhe analizuar dokumente dhe literatura e disponueshme, të rëndësishme për detyrën, gjatë gjithë procesit të hartimit të vlerësimit. Vlerësimi është zhvilluar duke u bazuar në raportin fillestar dhe strukturën e cila është aprovuar nga palët e interesit, si dhe mbi legjislacionin ekzistues, raportet dhe vlerësimet e kryera deri më tani. Literatura e shqyrtuar përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

Legjislacioni vendor:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi nr. 06/L-006);
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (Ligji nr. 06/L-084);
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L-074) dhe Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal nr. 06/L-074;
- Kodi i Procedurës Penale (Kodi nr. 08/L-032) dhe Ligji nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 08/L-032;
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (Ligji nr. 08/L-185);
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (Ligji nr. 04/L-218);
- Ligji për Familjen (Ligji nr. 2004/32);
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr. 08/L-255).

Instrumente ndërkombëtare:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR), ETS Nr. 5, 1950 dhe Protokollet;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual;
- Protokoli Opsional për Konventën për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë;
- Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë;

- Direktiva 2012/29/BE për standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;
- Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave;
- Direktiva 2016/800/BE për garancitë procedurale për fëmijët që janë të dyshuar ose të akuzuar;
- Strategjia e BE për të Drejtat e Fëmijëve (2021–2024);
- Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësi Miqësore për Fëmijët (2010);
- Rekomandimi CM/Rec (2018)7 për të drejtat e fëmijëve në ambientin digjital;
- Rekomandimi CM/Rec (2012)2 për pjesëmarrjen e fëmijëve nën 18 vjeç;
- Rekomandimi CM/Rec (2011)12 për të drejtat e fëmijëve dhe shërbime sociale miqësore;
- Udhëzime për kujdes shëndetësor miqësor për fëmijët (2011);
- Rekomandimi CM/Rec (2009)10 për strategji të integruara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- Rekomandimi R (98)8 për pjesëmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe shoqërore;
- Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (Nr. 1, 5, 6, 8, 10, 12);
- Rezoluta 2002/12 mbi Parimet Themelore për përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese në çështje penale.

Akte Nënligjore:

- Rregullorja (QKR) nr. 18/2024 për përcaktimin e procedurave efektive për identifikimin, raportimin dhe referimin e shfrytëzimit, neglizhencës dhe abuzimit ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 03/2024 për bashkëpunimin e strukturave dhe mekanizmave institucionalë me OJQ-të për zbatimin e politikave të drejtave dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve;
- Rregullorja (QKR) nr. 07/2024 për organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve;
- Rregullorja (QKR) nr. 23/2023 për procedurat e punës në tryezat shumë disiplinore për ndihmë në menaxhimin e rasteve;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2023 për përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse për të ndaluar pjesëmarrjen e fëmijëve në klube nate dhe hapësira të ngjashme;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 05/2023 për masat për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me drogë;

- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2023 për trajtimin mjekësor dhe psikologjik të fëmijëve viktime të abuzimit, për rehabilitim dhe ri-integrim;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 08/2022 për këshillin për të drejtat e fëmijës;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 07/2022 për autoritetet për të drejtat e fëmijës;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2022 për masa për mbrojtjen e fëmijëve nga faqet e internetit me përmbajtje pornografike dhe që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës;
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë miqësore për fëmijët në procedurat penale, civile dhe administrative.

Protokolle, Strategji, Raporte dhe Vlerësime:

- Karta e Vlerësimit të KOMF për kujdesin ndaj fëmijëve (2023, 2024);
- Vlerësimi i mbështetjes së BE-së për drejtësinë për të mitur në Kosovë (Raport përfundimtar 2018);
- Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijës në Kosovë (UNICEF, 2014);
- Strategjia për Mbrojtjen e Fëmijëve 2021–2030 (UNICEF);
- Reimagine Justice for Children (UNICEF, 2021);
- Vlerësimi i sistemeve administrative të dhënave për drejtësinë për fëmijët (UNICEF, 2021);
- Qasja e barabartë e fëmijëve në drejtësi – Evropa Qendrore dhe Lindore (UNICEF, 2015);
- Strategjia Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale (2018–2022);
- Standardet Minimale për Shërbimet Sociale (Standardet 1, 2, 3, 6 dhe 13);
- Hartimi dhe Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Kosovë (Zyra e Kryeministrit, 2012);
- Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën (2016–2024);
- Raportet e EULEX për Monitorimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (2021–2024).

Raportet Vjetore:

- Raportet të Policisë së Kosovës për vitet 2023-2024;
- Raportet të Prokurorisë së Shtetit për vitet 2023-2024;
- Raportet të Shërbimit Sprovues të Kosovës për vitet 2023-2024;
- Raportet vjetore nga aktorët e tjerë të përfshirë.

■ **Angazhimi i palëve të interesit përmes konsultimeve aktive**

Gjatë procesit të hartimit, eksperti ka siguruar komunikim të rregullt me zyrtarët përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë, KOMF dhe UNICEF Kosovë. Të gjitha veprimet dhe draftet janë ndarë dhe koordinuar me këta zyrtarë për të marrë komentet dhe miratimin e tyre përpara ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm.

Procesi është udhëhequr nga parimi i besimit dhe pronësisë së institucioneve relevante të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me synimin për të arritur koherencë ndërmjet tyre. Vlen të theksohet se gjatë gjithë procesit të zhvillimit, opinionet dhe nevojat e përfituesve, kanë qenë në qendër të punës. Është siguruar që zërat dhe pikëpamjet e tyre të dëgjohen dhe merren në konsideratë.

Drafti i parë preliminar është prezantuar para Ministrisë së Drejtësisë dhe përfituesve tjerë. Eksperti ka prezantuar draftin dhe ka lehtësuar takimin për të integruar komente nga aktorët të cilët ishin në punëtori dhe atyre që kishin dërguar komente, sugjerime apo vërejtje nëpërmjet emailit.

Bazuar në këto komente, eksperti ka vazhduar me draftimin e mëtejshëm të raportit të vlerësimit. Pas përfundimit të draftit të parë, dhe pas kryerjes së rishikimeve të nevojshme, eksperti, brenda afateve të akorduara, ka dorëzuar versionin final të vlerësimit në Ministrinë e Drejtësisë, KOMF dhe UNICEF.

1.4. Kufizimet dhe konsideratat etike

Gjatë realizimit të këtij vlerësimi janë respektuar parimet bazë etike, përfshirë vullnetarizmin e pjesëmarrësve, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për të refuzuar pjesëmarrjen në cilëndo fazë të procesit. Në veçanti, është treguar kujdes i shtuar gjatë trajtimit të informacionit që ndërlidhet me rastet praktike të ndara gjatë diskutimeve me profesionistët e fushës, duke u shmangur çdo formë rrezikimi ose stigmatizimi të pjesëmarrësve në vlerësim.

Megjithatë, vlerësimi është përballur me disa kufizime që kanë ndikuar në gjerësinë dhe thellësinë e analizës. Këto përfshijnë: qasjen e kufizuar në të dhëna zyrtare dhe statistika të përditësuara, mungesën e raporteve të detajuara mbi

zbatimin praktik të masave të diversitetit në nivel lokal, si dhe kohën e kufizuar për një angazhim më të thelluar me të gjithë aktorët përkatës.

Me gjithë dëshirën për të përfshirë zërin e të miturve që kanë përjetuar sistemin e drejtësisë për të mitur, kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të kufizimeve kohore.

Për shkak të këtyre kufizimeve kohore, nuk ishte e mundur të përmbusheshin të gjitha kërkesat formale për përfshirjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve në procesin e vlerësimit. Si rrjedhojë, vlerësimi është fokusuar në grumbullimin e të dhënave përmes dokumentacionit ekzistues, intervistave me profesionistë dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse, si dhe analizës së literaturës, duke u siguruar që nevojat dhe interesat e fëmijëve të mbesin në qendër të gjithë procesit analitik.

1.5. Drejtësi për të mitur apo drejtësi për fëmijë?

Çka përfshin drejtësia për të mitur?

Sistemi i drejtësisë për të mitur përfshin legjislacionin, normat, standardet, udhëzimet, politikat, procedurat, mekanizmat, dispozitat, institucionet dhe organet në mënyrë specifike të zbatueshme për fëmijët në konflikt me ligjin të cilët janë mbi moshën e përgjegjësisë penale³.

- Fokus i ngushtë, penal/juridik.
- I referohet sistemit të drejtësisë penale që trajton të miturit (zakonisht nën moshën 18 vjeç) në konflikt me ligjin, pra fëmijët që kanë kryer vepra penale.
- Përdoret për të përshkruar procedurat, institucionet dhe masat që merren ndaj fëmijëve si të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar.
- Përfshin masa si: paraburgimi, gjykimi, dënimi, masat e diversitetit ,etj.

³Guidance for legislative reform on juvenile justice. Guidance paper by Carolyn Hamilton. Published by UNICEF and Children's Legal Center, May 2011.

Shembull:

Një 17-vjeçar që është i dyshuar apo përballet me akuzë për vjedhje trajtohet në sistemin e drejtësisë për të mitur.

&

Një 14 vjeçari që i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor shokut të tij, sistemi i drejtësisë për të mitur i mundëson trajtimin përmes masave të diversitetit.

Çka përfshin drejtësia për fëmijë?

Qëllimi i drejtësisë për fëmijë është të sigurojë që fëmijët të kenë qasje më të mirë dhe të jenë më të mbrojtur nga sistemi i drejtësisë, përfshirë sektorët e sigurisë dhe mirëqenies sociale.

Kjo qasje synon posaçërisht zbatimin e plotë të normave dhe standardeve ndërkombëtare për të gjithë fëmijët që bien në kontakt me sistemin e drejtësisë apo sistemet e tjera të ndërlidhura, qoftë si viktimë, dëshmitarë, apo për çështje të tjera që kërkojnë ndërhyrje gjyqësore, administrative shtetërore apo jo shtetërore, siç janë kujdesi, kujdestaria apo mbrojtja e tyre⁴.

- Fokus më i gjerë, gjithëpërfshirës dhe ndër sektorial.
- Përfshin të gjithë fëmijët që hyjnë në kontakt me sistemin e drejtësisë, jo vetëm ata në konflikt me ligjin, por edhe: fëmijët viktimë, fëmijët dëshmitarë, fëmijët që kërkojnë mbrojtje nga sistemi.
- Merr parasysh të drejtat e fëmijëve në të gjitha aspektet e sistemit të drejtësisë, përfshirë trajtimin me dinjitet, pjesëmarrjen, mbrojtjen nga ri-viktimizimi, ndihmën juridike ,etj.
- Është më shumë në përputhje me shumë dispozita të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

⁴Guidance Note of the Secretary-General: UN Approach to Justice for Children, 2008.

Shembull:

Një 8 vjeçare që është viktimë e dhunës në familje dhe kërkon mbrojtje nga gjykata, hyn në fushën e drejtësisë për fëmijë.

&

Një fëmijë vajzë apo djalë nga 0 deri moshën 18 vjeçare, që është viktimë e abuzimit seksual qoftë nga bashkëmoshatarët apo edhe madhorët, duhet të trajtohet sipas parimeve dhe normave të drejtësisë për fëmijë.

Cilin sistem e zbaton Kosova?

Gjatë dy dekadave të fundit, në Kosovë është zhvilluar dhe përshtatur një sistem i drejtësisë për të mitur që trajton si të miturit që kanë arritur moshën e përgjegjësisë penale, ashtu edhe ata nën këtë moshë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e fëmijës.

Gjatë kësaj periudhe, janë miratuar një sërë ligjesh, janë zhvilluar procedura dhe standarde, janë krijuar institucione të specializuara dhe janë ndërtuar kapacitete të profesionistëve të fushës, të gjitha me qëllim mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të miturve që, për shkak të rrethanave jetësore, kanë rënë në konflikt apo kanë hyrë në kontakt me ligjin.

Reformat për ndërtimin e këtij sistemi nisën me hyrjen në fuqi të Ligjit Penal për të Mitur në vitin 2004, e më pas u thelluan me miratimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM) në vitin 2010. Ky Kod përfshinte risitë dhe standardet më të avancuara të asaj kohe, duke synuar një sistem më funksional dhe të përqendruar në interesin më të mirë të fëmijës.

Ndikimi i kësaj reforme u thellua më tej me rishikimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM) në vitin 2018, duke zgjeruar qëllimin dhe fushëveprimin e tij, nga koncepti tradicional i "drejtësisë penale për të mitur" drejt një kuptimi më të gjerë: "drejtësia për fëmijë". Ky ndryshim është përforcuar më tej edhe me hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ka sjellë përparime të rëndësishme në rregullimin e mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, duke fuqizuar më tej kornizën ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e tyre.

Ky ndryshim ishte një përgjigje e domosdoshme ndaj nevojës për të përfshirë jo vetëm fëmijët si autorë të veprave penale, por gjithashtu edhe ata që janë viktimë apo dëshmitarë të veprave penale, duke garantuar mbrojtje dhe trajtim të barabartë për të gjithë fëmijët që hyjnë në kontakt me sistemin e drejtësisë.


Duke marrë parasysh të gjithë legjisllacionin e aplikueshëm, në Kosovë ekzistojnë elemente të dy sistemeve – si të drejtësisë për të mitur, ashtu edhe të drejtësisë për fëmijë.

Cilat janë zhvillimet ndërkombëtare?

Sipas Udhëzuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Qasjen e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë për Fëmijë (2008), synohet të krijohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme për mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve brenda sistemit të drejtësisë. Këto strategji përfshijnë:

- Integrimin e çështjeve të drejtësisë për fëmijë në programet më të gjera për vendosjen e sundimit të ligjit. Kjo do të thotë se drejtësia për fëmijë nuk duhet të shihet si një sektor i izoluar, por si pjesë thelbësore e të gjitha përpjekjeve institucionale për ndërtimin e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë. Politikat dhe reformat në fushën e drejtësisë, sigurisë publike dhe mirëqenies sociale duhet të përfshijnë elemente që garantojnë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në çdo fazë të ndërveprimit të tyre me sistemin ligjor, qoftë si viktimë, dëshmitarë apo si të dyshuar.
- Forcimin e programeve shtesë dhe plotësuese që përmirësojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve, me fokus të veçantë në nisma që burojnë nga komuniteti, të cilat promovojnë qasjen në drejtësi për fëmijët dhe fuqizimin ligjor të grupeve të marginalizuara, siç janë fëmijët nga komunitetet e varfra, fëmijët me aftësi të kufizuara, ose ata që jetojnë në zona të thella rurale apo të izoluara. Këto programe synojnë të krijojnë mekanizma të mbrojtjes dhe përfaqësimit juridik të fëmijëve në mënyrë të barabartë dhe të arritshme.

Përmbledhje ilustruese



GRAFIKU 1: Ilustrim mbi pozicionin e drejtësisë për të mitur dhe drejtësisë për fëmijë brenda sundimit të ligjit

UNICEF thekson se drejtësia për fëmijë nuk ka të bëjë vetëm me trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, por edhe me ata që janë viktimë, dëshmitarë apo palë në procedura civile dhe administrative. Organizata promovon sisteme drejtësie që janë miqësore për fëmijët, duke garantuar që ata të trajtohen me dinjitet, të kenë qasje të barabartë në drejtësi dhe të dëgjohen në mënyrë efektive. UNICEF përkrah masa alternative ndaj ndëshkimeve tradicionale, si programet e drejtësisë restauruese dhe shërbimet në komunitet, për të shmangur paraburgimin dhe për të promovuar rehabilitimin e fëmijëve, me theks të veçantë masat e diversitetit.

1.6. Numri i të miturve në konflikt me ligjin⁵

Numri i kallëzimeve penale dhe numri i të miturve si kryerës të veprave penale

Gjatë vitit 2023 nëpër të gjitha Prokuroritë Themelore, janë pranuar 1868 kallëzime penale të reja me 2756 të mitur si kryerës të veprave penale, ndërsa në të njëjtin vit janë bartur nga viti paraprak 681 kallëzime penale me 1167 të mitur si kryerës të veprave penale që në total janë 2549 kallëzime penale dhe 3923 të mitur si kryerës të veprave penale.

⁵Të dhënat e paraqitura dhe analizuara në këtë nënkapitull janë marrë nga raporti zyrtar i dërguar nga Prokuroria e Shtetit për vitet 2023 dhe 2024.

Departamentet për të Mitur pranë Prokurorive Themelore në vitin 2023 kanë zgjidhur 1391 kallëzime penale, me 2124 të mitur si kryerës të veprave penale.

Viti	Kallëzime penale të reja	Të mitur si kryerës të veprave penale	Kallëzime penale të bartura nga viti paraprak	Të mitur si kryerës të veprave penale të bartura	Totali i kallëzimeve penale	Totali i të miturve si kryerës të veprave penale	Kallëzime të zgjidhura	Të mitur në kallëzime të zgjidhura
2023	1,868	2,756	681	1,167	2,549	3,923	1,391	2,124

TABELA 1: Të dhënat krahasuese viti 2023 për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale dhe të miturve si kryerës të veprave penale.

Gjatë vitit 2024 nëpër të gjitha Prokuroritë Themelore, janë pranuar 1994 kallëzime penale të reja me 3073 të mitur si kryerës të veprave penale, ndërsa në të njëjtin vit janë bartur nga viti paraprak 1157 kallëzime penale me 1799 të mitur si kryerës të veprave penale që në total janë 3151 kallëzime penale dhe 4872 të mitur si kryerës të veprave penale.

Departamentet për të Mitur pranë Prokurorive Themelore kanë zgjidhur 1749 kallëzime penale, me 2250 të mitur si kryerës të veprave penale.

Viti	Kallëzime penale të reja	Të mitur si kryerës të veprave penale	Kallëzime penale të bartura nga viti paraprak	Të mitur si kryerës të veprave penale të bartura	Totali i kallëzimeve penale	Totali i të miturve si kryerës të veprave penale	Kallëzime të zgjidhura	Të mitur në kallëzime të zgjidhura
2024	1,994	3,073	1,157	1,799	3,151	4,872	1,749	2,250

TABELA 2: Të dhënat krahasuese viti 2024 për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale dhe të miturve si kryerës të veprave penale.

Pra siç shihet numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale është rritur ndjeshëm nga 2549 në vitin 2023 në 3151 në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 23.6%. Po ashtu numri i të miturve të përfshirë si kryerës të veprave penale është rritur nga 3923 në vitin 2023 në 4872 në vitin 2024, që përfaqëson një rritje prej rreth 24.2%. Kjo rritje përputhet me rritjen e përgjithshme të kallëzimeve penale, duke sugjeruar një përkeqësim të situatës së përfshirjes së të miturve në kryerjen e veprave penale.

Sipas raportit vjetor të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023, numri i prokurorëve për të mitur pranë departamenteve për të mitur nëpër prokuroritë themelore është si në vijim:

P.TH Prishtinë	P.TH Prizren	P.TH Pejë	P.TH Mitrovicë	P.TH Gjiilan	P.TH Ferizaj	P.TH Gjakovë
3 Prokuror për të mitur	2 Prokuror për të mitur	2 Prokuror për të mitur	2 Prokuror për të mitur	1 Prokuror për të mitur	1 Prokuror për të mitur	1 Prokuror për të mitur
Totali						12 Prokuror

TABELA 3. Numri i prokurorëve për të mitur pranë Prokurorive Themelore

Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve dhe përfshirjes së të miturve në kallëzime penale

Të dhënat tregojnë një përmirësim të lehtë në përqindjen e zgjidhjes së kallëzimeve penale nga viti 2023 në vitin 2024. Në vitin 2023 janë zgjidhur 1391 kallëzime penale, që përbëjnë 54.6% të totalit, ndërsa në vitin 2024 janë zgjidhur 1749 kallëzime ose 55.5%. Edhe pse rritja në përqindje është modeste, vetëm 0.9 pikë përqindje, rritja në vlerë absolute është e konsiderueshme, me 358 kallëzime më shumë të zgjidhura.




TABELA 4: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve dhe përfshirjes së të miturve në kallëzime penale për vitin 2023




Tabela 5: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve dhe përfshirjes së të miturve në kallëzime penale për vitin 2024


Në vitin 2023, në kallëzimet e zgjidhura janë përfshirë 2124 të mitur, që përbëjnë 54.10% të rasteve. Ndërsa në vitin 2024 janë përfshirë 2250 të mitur, ose 46.20%. Kjo përfaqëson një rritje në vlerë absolute, por më të vogël në raport me rritjen e përgjithshme të numrit të të miturve të përfshirë, duke treguar një ulje të përqindjes së tyre në strukturën e përgjithshme të kallëzimeve të zgjidhura.

Pavarësisht efikasitetit të treguar në zgjidhjen e rasteve nga prokuroria, mbetet shqetësues fakti se një numër shumë i madh i kallëzimeve penale që përfshijnë gjithashtu një numër të konsiderueshëm të të miturve, vazhdon të bartet nga një vit në tjetrin. Të dhënat tregojnë se rreth 50% e rasteve, si në aspektin e kallëzimeve ashtu edhe të miturve të përfshirë, nuk zgjidhen brenda vitit kalendarik. Kjo situatë ngre dilema serioze në lidhje me zbatimin e parimeve themelore të drejtësisë për të mitur, e cila kërkon që trajtimi i këtyre rasteve të bëhet me urgjencë dhe brenda afateve sa më të shpejta të mundshme, në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës.

Mënyra e zgjidhjes së rasteve

Në vitin 2023, prej 1391 kallëzimeve penale me 2124 të mitur të përfshirë, janë zgjidhur si në vijim:

TABELA 6: *Mënyra e zgjidhjes së rasteve (viti 2023)*



Interpretimi i të dhënave nga Tabela 6 tregon dy qasje të ndryshme në vlerësimin e zbatimit të masave të diversitetit. Nëse të dhënat interpretohen vetëm në kuptimin e ngushtë, pra, duke u bazuar vetëm në rastet kur një masë diversiteti është shqiptuar formalisht, atëherë rezulton se vetëm 197 raste janë zgjidhur në këtë mënyrë.


Megjithatë, nëse të dhënat interpretohen në kuptimin e gjerë, sipas përkufizimeve të parashikuara në dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, atëherë shihet se përmes procedurave të shmangies, pra, raste ku nuk ka filluar procedura përgaditore, apo kur procedura është pushuar ose pezulluar, janë zgjidhur gjithsej 718 raste.

Edhe pse numri i rasteve në të cilat janë shqiptuar formalisht masa diversiteti mbetet i ulët, nëse bazohemi në interpretimin e gjerë të të dhënave, kjo paraqet një zhvillim pozitiv. Ajo dëshmon për një përdorim më të gjerë të formave alternative të ndërhyrjes nga ana e prokurorëve, në përputhje me parimet dhe rekomandimet e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që synojnë shmangien e përfshirjes së panevojshme të të miturve në procedura penale.

Megjithatë, ajo që nuk mund të kuptohet nga këto të dhëna është nëse, në rastet kur procedura nuk ka filluar, është pushuar apo pezulluar, prokurorët kanë përcaktuar ndonjë masë konkrete ndaj të miturit, apo rasti është zgjidhur pa asnjë masë konkrete. Mungesa e kësaj informate kufizon mundësinë për të vlerësuar plotësisht mënyrën e zbatimit të procedurave të shmangies dhe përputhshmërinë e tyre me qëllimet rehabilituese të sistemit të drejtësisë për të mitur.

Ndërsa në vitin 2024, prej 1794 kallëzimeve penale me 2250 të mitur të përfshirë, janë zgjidhur si në vijim:

TABELA 7: Mënyra e zgjidhjes së rasteve (viti 2024)



Sikurse më lartë, interpretimi i të dhënave nga Tabela 7 tregon dy qasje të ndryshme në vlerësimin e zbatimit të masave të diversitetit. Nëse të dhënat interpretohen vetëm në kuptimin e ngushtë, pra, duke u bazuar vetëm në rastet kur një masë diversiteti është shqiptuar formalisht, atëherë rezulton se vetëm 285 raste janë zgjidhur në këtë mënyrë, një rritje e ndjeshme nga viti 2023.

Megjithatë, nëse të dhënat interpretohen në kuptimin e gjerë, sipas përkufizimeve të parashikuara në dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, atëherë shihet se përmes procedurave të shmangies, pra, raste ku nuk ka filluar procedura përgatitore, apo kur procedura është pushuar ose pezulluar, janë zgjidhur gjithsej

849 raste, edhe këtu kemi një rritje të ndjeshme.

Edhe pse numri i rasteve në të cilat janë shqiptuar formalisht masa diversiteti mbetet i ulët, nëse bazohemi në interpretimin e gjerë të dhënave kjo paraqet një zhvillim pozitiv. Ajo dëshmon për një përdorim më të gjerë të formave alternative të ndërhyrjes nga ana e prokurorëve, në përputhje me parimet dhe rekomandimet e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që synojnë shmangien e përfshirjes së panevojshme të të miturve në procedura penale.

Megjithatë, ajo që nuk mund të kuptohet nga këto të dhëna është nëse, në rastet kur procedura nuk ka filluar, është pushuar apo pezulluar, prokurorët kanë përcaktuar ndonjë masë konkrete ndaj të miturit, apo rasti është zgjidhur pa asnjë masë konkrete. Mungesa e kësaj informacioni kufizon mundësinë për të vlerësuar plotësisht mënyrën e zbatimit të procedurave të shmangies dhe përputhshmërinë e tyre me qëllimet rehabilituese të sistemit të drejtësisë për të mitur.

Sidoqoftë, pavarësisht të dhënave nga viti 2023 dhe 2024, shmangia nga sistemi i drejtësisë penale, edhe në rastet kur nuk shqiptohet një masë konkrete, mbetet në interesin më të mirë të të miturit. Në fund të fundit, vendimmarrja i takon prokurorit, i cili, bazuar në rrethanat specifike të rastit, ushtron diskrecionin e tij për të përcaktuar rrugën procedurale më të përshtatshme me qëllim shmangien e të miturit nga përballja me procedurat penale formale.

Vërejtje!

Nga të dhënat e paraqitura në tabelat përkatëse, vërehet se për 3 të mitur në vitin 2023 dhe për 14 të mitur në vitin 2024 është regjistruar se **masa e diversitetit është shqiptuar nga ana e Gjykatës!!!**

Kjo paraqet një shqetësim serioz, pasi sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që ka hyrë në fuqi në vitin 2018, Gjykata nuk ka kompetencë për të shqiptuar masa të diversitetit. Shqiptimi i masave të diversitetit është në kompetencën dhe diskrecionin ekskluziv të prokurorit.

Nga interpretimi i përgjithshëm i tabelave më lart, duke mbledhur të gjitha shifrat sipas kuptimit të gjerë, del që një numër relativisht i ulët i të miturve respektivisht **33%** shmangen nga sistemi i drejtësisë ose nga dërgimi në procedurë të rregullt gjyqësore. Kjo do të thotë se **67% e të miturve** janë referuar në Gjykatë për vendosje, që paraqet një përqindje të lartë të miturve që përballen me procedura gjyqësore.

E nëse interpretojmë të dhënat nga tabelat më lart sipas kuptimit të ngushtë, duke llogaritur vetëm numrin e masave të diversitetit del një numër absolut i ulët i të miturve, respektivisht **10%** e tyre shmangen nga sistemi i drejtësisë ose nga dërgimi në procedurë të rregullt gjyqësore. Kjo do të thotë se **90% e të miturve** janë referuar në Gjykatë për vendosje, që paraqet një përqindje të lartë të të miturve që përballen me procedura gjyqësore.

Megjithatë, është e vështirë të konstatohet me saktësi nëse të gjithë të miturit e referuar në Gjykatë kanë përfunduar procedurat në përputhje me parimet e shmangies nga ndjekja penale. Kjo për shkak se Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton kritere të qarta për zbatimin e masave të diversitetit, ndërkohë që i jep prokurorit diskrecionin për të vendosur nëse një rast do të trajtohet përmes një mase alternative apo do të referohet në gjykatë.

Në intervistat e zhvilluara me profesionistë të sistemit të drejtësisë për të mitur, është theksuar se një pjesë e konsiderueshme e të miturve janë recivistë ose të përfshirë në vepra penale të rënda, të cilët nuk i përmbushin kriteret për zbatimin e masave të shmangies. Kjo përbën një ndër faktorët kryesorë që ndikon në përqindjen e lartë të rasteve të dërguara në gjykatë.

Kjo e gjetur nënvizon nevojën për një analizë më të thelluar të praktikës vendimmarrëse të prokurorëve, si dhe të llojit të veprave penale ku të miturit janë të përfshirë, me qëllim që të kuptohet më mirë hapësira reale për zbatimin e mekanizmave alternativë ndaj ndjekjes penale.

KAPITULLI II:

MASAT E DIVERSITETIT

1.1. Baza ligjore dhe institucionet e mandatuara

Legjislacioni vendor

Në Kosovë ekziston një korpus i gjerë i akteve juridike që rregullojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve, përfshirë edhe të miturit në konflikt, duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik, e deri te aktet nënligjore që përcaktojnë standardet e zbatimit praktik.

Edhe pse Kosova nuk është formalisht nënshkruese e konventave ndërkombëtare për shkak të statusit të saj ndërkombëtar, neni 22 i Kushtetutës së Kosovës siguron zbatimin e drejtpërdrejtë të një numri të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndër të cilat përfshihet edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (paragrafi 7). Kushtetuta jo vetëm që e inkorporon këtë Konventë në rendin e brendshëm juridik, por gjithashtu i jep përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera në rast konflikti, duke theksuar se:

“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”

Duke marrë parasysh këtë bazë kushtetuese, si dhe nevojën për mbrojtje të posaçme të fëmijëve për shkak të papjekurisë së tyre fizike dhe mendore, neni 50 i Kushtetutës rregullon drejtat themelore të fëmijëve, duke përcaktuar në paragrafin 1 se: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.”* Ndërsa në paragrafin 4 të të njëjtit nen, përcaktohet qartë parimi i interesit më të mirë të fëmijës, duke theksuar se: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”*

Gjithashtu, në nenin 31, paragrafi 7, që ka të bëjë me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Kushtetuta përcakton se: *“Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”*

Bazuar në këto dispozita kushtetuese, është ndërtuar një kornizë e gjerë ligjore që synon mbrojtjen dhe trajtimin e të miturve, veçanërisht atyre që janë në konflikt me ligjin. Në këtë kontekst, themel i infrastrukturës ligjore për drejtësinë për fëmijë ka qenë miratimi i:

- ☐ Ligjit për të Mitur në vitin 2004;
- ☐ Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM) në vitin 2010, dhe më pas;
- ☐ Kodit të Drejtësisë për të Mitur në vitin 2018 (Kodi Nr. 06/L-006).

Kodi i Drejtësisë për të Mitur i vitit 2018 (Kodi Nr. 06/L-006), i cili është në fuqi, ka sjellë një sërë ndryshimesh dhe risish të rëndësishme që kanë për qëllim avancimin e mbrojtjes dhe trajtimit të të miturit si kryerës i veprës penale. Ky Kod paraqet një qasje bashkëkohore dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, duke përfshirë një sistem drejtësie që bazohet në parime si interesi më i mirë i fëmijës, parimi i proporcionalitetit, rehabilitimi, dhe ri integrimi i të miturit në shoqëri.

Ndryshimet dhe risitë e përfshira në këtë Kod shënojnë një kthesë të qartë në orientimin e sistemit të drejtësisë për fëmijë në Kosovë, duke i dhënë përparësi masave alternative ndaj ndëshkimit klasik penal dhe duke promovuar drejtësinë restauruese si një formë më humane dhe efektive të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Duke u bazuar në trendet e fundit në nivel global, të cilat kanë sjellë zhvillime të rëndësishme në eksplorimin dhe zbatimin e formave të reja të masave të diversitetit dhe atyre edukative, Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë ka reflektuar këto përparime përmes inkorporimit të masave të reja dhe zgjerimit të konsiderueshëm të gamës së masave ekzistuese të diversitetit. Konkretisht, është bërë dyfishimi i numrit të masave të diversitetit, nga tetë (8) sa ishin në versionin paraprak të Kodit, në gjashtëmbëdhjetë (16), përfshirë edhe tetë (8) masa të reja⁶.

Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të drejtësisë për të mitur më gjithëpërfshirës, me fleksibilitet dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, i cili synon parandalimin e dënimit me burgim,

⁶Neni 20 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KODI Nr. 06/L-006) i Shpallur në Gazetën Zyrtare 18 Tetor 2018.

rehabilitimin dhe ri integrimin social të të miturve, përmes masave që janë të orientuara drejt edukimit, përgjegjshmërisë personale dhe mbështetjes psiko-sociale.

Instrumentet kryesore regjionale dhe ndërkombëtare

Masat e diversitetit, ashtu si edhe masat dhe dënimet alternative, bazohen dhe rrjedhin nga një sërë instrumentesh ndërkombëtare që tashmë janë të njohura dhe të zbatueshme edhe në Kosovë. Këto instrumente përbëjnë bazën normative për rregullimin dhe zbatimin efektiv të një sistemi të drejtësisë penale që është në përputhje me të drejtat e fëmijëve dhe me standardet ndërkombëtare për trajtimin e të miturve që hyjnë në kontakt me ligjin.

Instrumentet kryesore ndërkombëtare që shërbejnë si bazë ligjore dhe rregullatore përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989), garanton të drejtat themelore të fëmijëve, përfshirë të drejtën për mbrojtje nga ndëshkimi i ashpër dhe e drejta për rehabilitim, duke i dhënë përparësi masave alternative (përfshirë shmangien nga sistemi i drejtësisë), kundrejt burgimit dhe masave tjera institucionale;*
- *Rregullat e OKB-së për Standardet Minimale për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985);*
- *Rregullat e Riadit - Rregullat e OKB-së për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjtë (1990);*
- *Parimet Bazë të Përdorimit të Programeve të Drejtësisë Restauruese në Çështjet Penale (Rezoluta 2002/12);*
- *Rezoluta 2005/20 - Udhëzimet për Drejtësinë që përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimit;*
- *Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (1997);*
- *Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, përkatësisht:*
 - *Komenti Nr. 10 (2007) mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur;*
 - *Komenti Nr. 12 (2009) mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar;*
 - *Komenti Nr. 24 (2019) mbi të drejtën e fëmijës në sistemin e drejtësisë penale;*
- *Udhëzimet e Këshillit të Evropës për një Drejtësi Miqësore për Fëmijët (2010).*

Këto instrumente përbëjnë bazën për ndërtimin e një sistemi të drejtësisë për të mitur që është jo vetëm ndëshkues, por edhe edukues, restaurues dhe miqësor ndaj fëmijës, duke nxitur riintegrimin e tij në shoqëri.

Institucionet kryesore të mandatuara

Në bazë të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe akteve përkatëse nënligjore, institucionet kyçe për zbatimin efektiv të masave të diversitetit përfshijnë⁷: Prokurorinë, Policinë e Kosovës, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, si dhe aktorë të tjerë të sektorit publik dhe joqeveritar.

Prokuroria: përkatësisht prokurorët e specializuar për të mitur, janë institucioni përgjegjës për iniciimin dhe vendimmarrjen lidhur me aplikimin e masave të diversitetit. Vendimi për shmangie nga procedura penale merret në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kod dhe bazohet në parimin e interesit më të mirë të miturit dhe në vlerësimin e rrethanave të veçanta të rastit. Në këtë kuadër, prokurori ka një kompetencë të zgjeruar për të vlerësuar jo vetëm elementet juridike, por edhe ato sociale dhe edukative që lidhen me të miturin.

Policia e Kosovës: përmes njësive respektive, përfshihet në fazat e para të procedurës dhe ka mandat që të propozojë masën e diversitetit-vërejtja policore në koordinim me prokurorin e rastit. Po ashtu, Policia luan një rol të rëndësishëm në mbledhjen e informacionit fillestar, në sigurimin e kushteve për intervistim miqësor për fëmijët dhe në ndërmjetësim me strukturat e tjera përkatëse.

Shërbimi Sprovues i Kosovës: është një nga institucionet kyçe në aspektin praktik të ekzekutimit të masave të diversitetit dhe masave të tjera alternative ndaj dënimit me burg. Ky shërbim është përgjegjës për hartimin e planeve individuale të mbikëqyrjes, ofrimin e mbështetjes psiko-sociale dhe raportimin periodik mbi ecurinë e zbatimit të masave të diversitetit. Profesionalizmi dhe kapacitetet institucionale të këtij shërbimi janë kritike për arritjen e rezultateve të qëndrueshme në ri-integrimin e të miturve.

Qendrat për Punë Sociale: në bashkëpunim dhe me kërkesën e Shërbimit Sprovues, luajnë një rol plotësues në mbështetjen e të miturit gjatë zbatimit të masave, sidomos në aspektin familjar, social dhe të mirëqenies. Këto qendra janë përgjegjëse për identifikimin e nevojave të fëmijës, ndihmën në zhvillimin e planeve individuale të rehabilitimit dhe ndërmarrjen e intervenimeve psiko-sociale.


⁷ Me ndryshimet e KDM të vitit 2018, Gjykata nuk ka rol në shqiptimin dhe ekzekutimin e Masave të Diversitetit.

Përveç institucioneve publike, në procesin e zbatimit të masave të diversitetit shpeshherë përfshihen edhe organizata të shoqërisë civile, institucione edukative dhe profesionale, si dhe profesionistë të ndryshëm, të cilët kontribuojnë në realizimin e programeve edukative, trajnimeve ose shërbimeve që janë pjesë e masave të caktuara. Përfshirja e këtyre aktorëve shton dimensionin komunitar të procesit të ri-integrimit dhe fuqizon modelin restaurues të drejtësisë për të mitur.

1.2. Qëllimi, llojet dhe risitë

Qëllimi

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës gjyqësore ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe ri integrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste⁸.



GRAFIKU 2: Ilustrim mbi qëllimet e masave të diversitetit

⁸Neni 19 i KDM.

Llojet dhe risitë

Masat e reja të diversitetit të përfshira në Kodin e Drejtësisë për të Mitur përfaqësojnë një risi substanciale në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Këto masa pasqyrojnë qartë nevojën për një qasje të orientuar në interesin më të mirë të të miturve dhe nevojat individuale në raport me situatat konkrete të tyre, duke ofruar mundësi të reja për intervenim efektiv dhe të përshtatur.

Për më tepër, risitë e sjella nga këto masa nuk janë të rëndësishme vetëm për të miturit, por edhe për vetë profesionistët e përfshirë në sistemin e drejtësisë për të mitur. Ato krijojnë hapësira më të gjera për përdorimin e mjeteve alternative dhe edukative në vend të privimit të lirisë apo formave të tjera institucionale, duke kontribuar drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të rehabilitimit, ri-socializimit dhe re integritit të suksesshëm të të miturve në shoqëri.

Masat prezente⁹

- ✓ Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
- ✓ Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
- ✓ Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- ✓ Vijimi i rregullt në shkollë;
- ✓ Pranimi i punësimit apo aftësimin në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
- ✓ Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;
- ✓ Edukimi në rregullat e trafikut;
- ✓ Këshillimi psikologjik.

$$8 + 8 = 16$$

⁹Këto masa kanë qenë prezente dhe janë zbatuar prej Ligjit Penal për të Mitur (2004) dhe pastaj edhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (2010).

Risitë në KDM të vitit 2018

- ☆ Angazhimi në aktivitete bamirësie;
- ☆ Pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- ☆ Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative;
- ☆ Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve;
- ☆ Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;
- ☆ Të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;
- ☆ Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit;
- ☆ Vërejtja policore.

Masat e diversitetit luajnë një rol thelbësor në parandalimin e delikucencës së të miturit, duke ofruar alternativa ndaj procedurave tradicionale penale, të cilat shpeshherë mund të kenë efekte negative në zhvillimin personal dhe social të tij. Përmes masave të diversitetit, synohet shmangia e stigmatizimit që mund të rezultojë nga një proces penal formal dhe mbajtja e të miturit larg sistemit të drejtësisë penale, duke i mundësuar atij një trajtim më të përshtatshëm dhe të orientuar drejt rehabilitimit.

Këto masa ofrojnë mundësinë për të promovuar përgjegjësinë personale të të miturit, duke e inkurajuar atë të reflektojë mbi pasojat e veprimeve të tij dhe të përmirësojë sjelljen përmes përfshirjes në programe edukative, trajnime profesionale, ndërmjetësim ose aktivitete komunitare. Në këtë mënyrë, masat e diversitetit ndihmojnë në riparimin e dëmit të shkaktuar dhe kontribuojnë në ri integrimin e të miturit në shoqëri.

2.3. Shqiptimi i masave

Zbatimi i masave të diversitetit në vitet 2023 dhe 2024¹⁰

Gjatë vitit 2023, janë zbatuar nga Shërbimi Sprovues gjithsej 237 masa të diversitetit, nga të cilat 4 nuk janë ekzekutuar, duke rezultuar në një normë zbatimi prej rreth 98.3%.

Në vitin 2024, numri i masave të zbatuara nga Shërbimi Sprovues është 305, ndërsa 11 prej tyre nuk janë ekzekutuar, që përfaqëson një normë zbatimi prej rreth 96.4%.




TABELA 8: Numri i masave të shqiptuara dhe të (pa)ekzekutuara

Këto të dhëna tregojnë një rritje të dukshme të përdorimit të masave të diversitetit nga viti 2023 në 2024 (përkatësisht një rritje prej rreth 28.7%), megjithatë vërehet edhe një rritje në numrin e masave të pa ekzekutuara.

¹⁰Të dhënat janë nxjerrë dhe përpunuar nga raportet zyrtare të Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Mospërputhje:

Në analizën e të dhënave statistikore për masat e diversitetit të zbatuara gjatë viteve 2023 dhe 2024, vërehet një mospërputhje midis statistikave të raportuara nga Prokuroria e Shtetit dhe ato të Shërbimit Sprovues të Kosovës:

Viti	Prokuroria e Shtetit	Shërbimi Sprovues
2023	197 masa	237 masa
2024	285 masa	305 masa

Krahasim i masave të zbatuara në dekadën e fundit

Të dhënat e paraqitura në grafik për periudhën 10-vjeçare (2015–2024), paraqesin një trend të luhatur të numrit të masave që janë zbatuar nga ana e Shërbimit Sprovues.




TABELA 9: *Trendi i masave të shqiptuara*

Shifrat në tabelën 9, dëshmojnë një trend paradoksal dhe në të njëjtën kohë shqetësues, në vend që hyrja në fuqi e Kodit të ri të Drejtësisë për të Mitur të shoqërohej me rritje të përdorimit të masave të diversitetit, të dhënat tregojnë një rënie të dukshme të tyre krahasuar me periudhën e mëparshme. Kjo është

veçanërisht shqetësuese duke marrë parasysh se ndryshimet ligjore kanë synuar rritjen e përdorimit të këtyre masave, duke zgjeruar gamën e tyre nga 8 në 16, si dhe duke lehtësuar procedurat për shqiptimin e tyre.

2.4. Format dhe mënyrat e shqiptimit

Procedura për shqiptimin e masave të diversitetit paraqet një nga momentet kyçe në zbatimin praktik të drejtësisë për të mitur. Kjo procedurë është veçanërisht e rëndësishme, pasi nga vendimi i Prokurorit të Shtetit varet jo vetëm rrjedha e mëtejme e rastit penal ndaj të miturit, por edhe mundësia për ta orientuar çështjen drejt një trajtimi alternativ dhe më të favorshëm për rehabilitimin e tij.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë disa mënyra apo rrugë procedurale që Prokurori i Shtetit mund t'i ndjekë para se të shqiptojë një masë diversiteti. Këto rrugë ofrojnë fleksibilitet dhe mundësi për një qasje të individualizuar ndaj çdo rasti, duke pasur parasysh rrethanat personale dhe sociale të të miturit, llojin dhe rrezikshmërinë e veprës penale, si dhe gatishmërinë e të miturit për të bashkëpunuar dhe për të marrë përgjegjësi.

Pra, me shqiptimin e masës së diversitetit **synohet mos fillimi i procedurës gjyqësore**, nëpërmjet të cilës shmanget mundësia që i mituri të përfshihet në procedura të panevojshme gjyqësore respektivisht mbajtja e të miturit larg procedurave që mund të ndikojnë negativisht në trajtimin dhe edukimin e tij apo saj.

Procedura Gjyqësore e përcaktuar në nenin 19 të KDM përfshin të gjitha veprimet që ndërmerren nga institucionet dhe profesionistët e drejtësisë për të mitur në kuptim të vërtetësisë së dyshimit të bazuar. Për më tepër kjo përfshinë të gjitha fazat e procedurës penale, ashtu siç janë përcaktuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe përshtatshmërisht edhe në Kodin e Procedurës Penale. Prandaj, Kodi nuk ka përcaktuar ndonjë fazë në mënyrë taksative, por ka përcaktuar procedurën gjyqësore e cila përfshin të gjitha fazat pa përjashtim.

Fjalja **“kur është e mundur”** e përdorur në nenin 19 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur i jep Prokurorit të Shtetit një hapësirë të konsiderueshme diskrecioni për të vlerësuar nëse janë përmbushur kushtet për shqiptimin e një mase të diversitetit. Ky formulim nuk është i rastësishëm; përkundrazi, ai nënvizon nevojën për një

vlërësim individual të secilit rast, duke marrë parasysh rrethanat specifike të të miturit, natyrën e veprës penale, si dhe nivelin e bashkëpunimit dhe pendesës së treguar.

Në këtë kontekst, Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë tri rrugë procedurale të cilat Prokurori i Shtetit mund t'i ndjekë përpara vendimit për shqiptimin e masës së diversitetit. Këto rrugë, me gjithë dallimet në mënyrën e zbatimit, ndajnë një qëllim të përbashkët: shmangien e përfshirjes së panevojshme të të miturit në sistemin formal të drejtësisë penale, kurdo që kjo është e mundur dhe e arsyeshme.

A) Përshtatshmëria apo siç është i njohur si parimi i oportunitetit

*'Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë **të mos fillojë procedurën përgatitore** edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori i shtetit për të mitur mendon se nuk do të ishte **e përshtatshme** të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.' (Neni 52 par.2 i KDM)*

B) Pezullimi i ndjekjes

*'Prokurori i shtetit për të mitur **mund të pezullojë ndjekjen e veprës penale** dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 21 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.' (Neni 49 i KDM)*

C) Pushimi i procedurës përgatitore

Prokurori i shtetit për të mitur e **pushon procedurën përgatitore** kurdo që nga provat e mbledhura konstatohet se:

1.4. janë prezente kushtet e parapara **në paragrafin 2 të nenit 52 të këtij Kodi**. (56 par.1 nënparagrafi 1.4 i KDM)

Përshtatshmëria apo mos fillimi i procedurës përgatitore përbën rrugën dhe formën kryesore për vendosjen e masave të diversitetit. Megjithatë, edhe pezullimi i ndjekjes penale dhe pushimi i procedurës përgatitore janë forma përmes së cilave mund të shqiptohen këto masa. Të tre këto opsione përfaqësojnë rrugët procedurale të rëndësishme që kontribuojnë në realizimin e qëllimit kryesor të masave të diversitetit.

Dobitë dhe përparësitë

Shqiptimi dhe ekzekutimi me sukses i masave të diversitetit ka shumë përparësi dhe dobi jo vetëm për të miturit, por edhe për familjen, komunitetin dhe vetë sistemin e drejtësisë në përgjithësi¹¹.

Përfitimet e të miturve:

- Parandalimi që të miturit të vuajnë nga ndikimi negativ zhvillimor i lidhur me procedurat gjyqësore formale, duke përfshirë stigmatizimin e fëmijës (dhe familjes së tyre) dhe nga evidenca penale;
- Parandalon ndikimin negativ dhe afatgjatë të burgimit në zhvillimin e shëndetit fizik, mendor dhe emocional të të miturit, si dhe rritjen e mundësisë për të përsëritur veprat penale që vijnë si pasojë e privimit nga liria;
- Sigurohen për shpejtësinë dhe bartjen e pasojave nga sjellja dhe kryerja e veprës penale;
- Synohet zbulimi i arsyeve që kanë ndikuar në sjelljen e kryerësit të mitur për të kryer atë vepër penale, identifikimi dhe adresimi i nevojave të fëmijës si dhe ofrimi i aktiviteteve efektive rehabilituese;
- Kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin e të miturit;
- E përfshin fëmijën dhe mundëson të kuptojë pasojat e veprës së kryer;

¹¹ Five Advocacy Briefs on Child Justice. Diversion of Children in Conflict with the Law from Formal Judicial Proceedings in Europe and Central Asia. UNICEF Regional Office for Europe and Central Asia. November 2022.

- Inkurajon fëmijën në marrjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, në atë mënyrë që e rehabiliton dhe re integron atë në shoqëri, me theks të veçantë nëse shmangia është e kombinuar sipas qasjes së drejtësisë restauruese.

Përfitimet e shoqërisë:

- Zvogëlohet mundësia për recidivizëm;
- Evitohen kostot e larta nga procedimi i rastit nëpërmjet sistemit formal të drejtësisë;
- Evitohen kostot e larta nga mbajtja në paraburgim të miturve;
- Riparohet dëmi i shkaktuar nëse shmangia kombinohet me qasjen e drejtësisë restorative;
- Kontribuon në zhvillimin social dhe zgjidhjen e konfliktit;
- Ndikon dhe kontribuon në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe vendosjes së nevojave të viktimës në qendrës të procesit nëse shmangia kombinohet me qasjen e drejtësisë restorative;
- Kontribuon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë kombëtare duke promovuar përfshirjen se sa përjashtimin e të miturve që janë të cënueshëm.

Përfitimet e sistemit:

- Zvogëlohet numri i të miturve dhe veprave të lehta të cilat e ngulfatshin sistemin gjyqësor formal, si dhe lejojnë që resurset të fokusohen tek recidivistët dhe kryerësit që janë me rrezikshmëri të lartë;
- Zvogëlon numrin e të miturve që privohen nga liria, e cila mund të ndikojë në përmirësimin e kushteve të atyre të miturve që tashmë janë privuar nga liria;
- Ju mundëson zyrtarëve të sektorit të drejtësisë për tu marrë me rastin në mënyrë ekspeditive;
- Rrit profesionalizmin, kënaqësinë në punë dhe moralin e personelit që punon në sektorin e drejtësisë për të mitur.

KAPITULLI III:

PÄRMBYLLJE

3.1. Të gjeturat e vlerësimit

Në bazë të vlerësimit të realizuar dhe analizës së detajuar të zbatimit të masave të diversitetit në sistemin e drejtësisë për të mitur në Kosovë, janë identifikuar një sërë të gjeturash kyçe që lidhen me përvojat pozitive, sfidat strukturore dhe pengesat praktike që ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Nga njëra anë, janë vërejtur praktika pozitive që dëshmojnë përkushtimin institucional për të promovuar masat e diversitetit dhe për t'i përdorur ato në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Nga ana tjetër, vlerësimi ka evidentuar sfida serioze në zbatimin e njëtrajtshtëm të këtyre masave në të gjitha prokuroritë themelore, mungesë të standardizimit në praktikë, dhe pengesa të natyrës institucionale dhe administrative, të cilat kufizojnë ndikimin pozitiv që këto masa mund të kenë tek të miturit në kontakt me ligjin.

Të gjeturat e vlerësimit të realizuar janë kategorizuar në dy grupe kryesore për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi masat e diversitetit në sistemin e drejtësisë për të mitur në Kosovë.

1.1.1. Të gjeturat për secilën masë veçmas

Grupi i parë i të gjeturave përqendrohet në një analizë të detajuar të secilës masë të diversitetit individualisht, duke identifikuar qëllimin e secilës masë sipas përcaktimeve në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, si dhe duke vlerësuar nëse dhe në çfarë mase ajo është zbatuar në praktikë.

Të gjeturat janë ofruar në një formë tabelore më qëllim kuptimin më të lehtë të asaj se çka ka synuar KDM, cilat janë të dhënat për dy vitet e fundit, dhe çfarë të gjeturash janë ndërlidhur me secilën masë.

(M1¹²) Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë përfshin realizimin e një procesi pajtimi midis të miturit që ka kryer veprën dhe palës së dëmtuar, me qëllim të riparimit të dëmit dhe rivendosjes së marrëdhënieve sociale. Pajtimi mund të përfshijë një kërkim falje të drejtpërdrejtë nga i mituri ndaj palës së dëmtuar, si dhe veprime të tjera që kontribuojnë në rikuperimin emocional dhe moral të palës së dëmtuar dhe rehabilitimin e të miturit. Procesi realizohet me pëlqimin e të dy palëve dhe në prani të një ndërmjetësi të trajnuar.	2023 129 Masa (117-M¹³) (13-F)	Statistikat e dy viteve të fundit tregojnë një rritje në zbatimin e masës së pajtimit, e cila, për habi, rezulton të jetë masa më e aplikuar ndër masat e diversitetit të parashikuara me KDM. Nga analiza e opinioneve të profesionistëve të përfshirë në vlerësim, del se kjo masë perceptohet si më e lehtë për t'u shqiptuar nga ana e prokurorëve dhe kërkon më pak veprime procedurale krahasuar me masa të tjera. Në shumicën e rasteve, zbatimi i saj realizohet në mënyrë të menjëhershme, me përmbylljen e kërkesës për falje nga ana e të miturit ndaj palës së dëmtuar, duke e përmbyllur procesin pa nevojën e ndërmarrjes së veprimeve tjera përgatitore.
Kjo masë sikurse masa M2 mund të zbatohet në mënyrë të përshtatshme përmes procedurave të ndërmjetësimit, pasi ato përbajnë elemente thelbësore të kësaj procedure. Rregullat dhe parimet që vlejné për ndërmjetësimin mund të aplikohen edhe për këto masa, me përjashtim të rasteve kur pajtimi ndodh menjëherë në polici ose prokurori, ku procedura e ndërmjetësimit nuk është e nevojshme dhe pajtimi mund të dokumentohet drejtpërdrejt në aktet zyrtare.	2024 148 Masa (135-M) (13-F)	Sidoqoftë, profesionistët theksojnë se numri real i këtyre masave do të ishte dukshëm më i lartë, nëse një pjesë e rasteve nuk do të kalonte në procedurën formale të ndërmjetësimit, e cila rregullohet sipas Ligjit për Ndërmjetësim dhe Kapitullit II të KDM-së. Kjo ndarje procedurale, në disa raste, përbën një pengesë praktike për shqyrtimin dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të masës së pajtimit, duke ndikuar në numrin përfundimtar të rasteve që përfshihen nën këtë masë diversiteti. Ekzistonin edhe mendime se kjo masë nuk do duhej të përfshihej në kuadër të masave të diversitetit, por të trajtohej në procedurën e ndërmjetësimit me të mitur.

“Pajtimi, si masë e diversitetit, funksionon më mirë kur ka ndërmjetësim cilësor dhe pjesëmarrje të vullnetshme nga të dyja palët. Por jo gjithmonë realizohet në praktikë siç duhet, nganjëherë kërkimi faljes bëhet formalisht, pa një proces të thelluar reflektimi nga i mituri.” Zyrtar i Shërbimit Sprovues¹⁴

¹² M-Numri i masës sipas renditjes në KDM!

¹³ M-Meshkuj/Djem F-Femra/Vajza

¹⁴ Në fund të secilës masë kemi përzgjedhur nga një kuotë të shkëputur nga intervistat gjysëm të strukturuar apo nga punëtorja me grupet e fokusit.

(M2) Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij		
Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë synon rindërtimin e marrëdhënieve familjare përmes pajtimit ndërmjet të miturit që ka kryer veprën penale dhe anëtarëve të familjes së tij. Pajtimi mund të përfshijë komunikim të ndërmjetësuar, kërkim falje, diskutim të ndikimit të sjelljes së të miturit në familje, si dhe angazhimin e ndërsjellë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe mbështetjen në procesin e rehabilitimit të miturit. Masa zbatohet në mënyrë vullnetare dhe me pëlqimin e palëve, në prani të një profesionisti apo ndërmjetësi të kualifikuar.	2023 4 Masa (3-M) (1-F)	Të dhënat statistikore tregojnë një rritje të ndjeshme të zbatimit të kësaj mase nga viti 2023 (4 masa) në vitin 2024 (17 masa), që përfaqëson një rritje katërfish. Pjesa më e madhe e rasteve i takojnë të miturve meshkuj. Sipas profesionistëve të intervistuar, kjo masë vazhdon të zbatohet në mënyrë të kufizuar për dy arsye: ▪ Për shkak të llojit të veprave penale (ka numër të vogël të veprave penale që kryhen brenda familjes); ▪ Për shkak të ndjeshmërisë së lartë të marrëdhënieve familjare, dhe hezitimit të vetë familjeve për të marrë pjesë në një proces të mirëfilltë pajtimi. Ky ngurrim është veçanërisht i theksuar në raste kur ekziston mungesë besimi ose komunikimi brenda familjes, duke e bërë zbatimin e masës më kompleks dhe më të ndjeshëm në praktikë.
	2024 17 Masa (15-M) (2-F)	Edhe të kjo masë ekzistonin mendime se kjo masë nuk do duhej të përfshihej në kuadër të masave të diversitetit, por të trajtohej në procedurën e ndërmjetësimit me të mitur.

“Shumë prindër nuk e kuptojnë rolin e tyre në rehabilitimin e të miturit. Ka raste kur ata e shohin pajtimin si një formalitet për të mbyllur çështjen, jo si një hap drejt ndryshimit të marrëdhënieve në familje.” **Prokurori për të Mitur**

(M3) Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellët ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të miturit

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë parashikon që i mituri t'i kompensojë viktimës dëmin material apo jo material, përmes pagesës ose ndonjë veprimi simbolik (p.sh. riparimi i një makine). Marrëveshja për kompensim mund të jetë edhe gojore dhe duhet të përfshijë përfaqësuesin ligjor të të miturit, i cili ndihmon në mbikëqyrjen dhe realizimin e saj. Shqiptimi i kësaj mase varet nga gjendja financiare e të miturit dhe mund të zbatohet edhe për kompensim të pjesshëm ose jo-monetar.	2023 9 Masa (9-M) (0-F)	Kjo masë është zbatuar në një numër shumë të kufizuar rastesh, përkatësisht në 9 raste në vitin 2023 dhe 8 raste në vitin 2024. Këto shifra tregojnë një përdorim të ulët të saj, pa ndonjë progres të dukshëm. Sipas profesionistëve të intervistuar, shkalla e ulët e zbatimit të kësaj mase lidhet kryesisht me vështirësitë ekonomike të vetë të miturve dhe familjeve të tyre, të cilët shpesh nuk kanë mundësi reale për të kompensuar dëmet materiale. E vështirësia më e madhe sipas tyre është kushti që kërkon kjo masë “<i>situatën financiare të të miturit</i>”, ku në të shumtën e rasteve të miturit nuk kanë mjete financiare. Një tjetër faktor është mungesa e njohjes dhe interpretimit të qartë të asaj çka përbën “kompensim simbolik” ose “jo-material”, gjë që kufizon kreativitetin në aplikim.
	2024 8 Masa (8-M) (0-F)	Në disa raste është vërejtur edhe hezitim nga ana e viktimave për të hyrë në marrëveshje të këtij lloji, sidomos kur dëmshpërblimi nuk përmbush pritshmërinë e tyre ose nuk shihet si i mjaftueshëm për riparimin e dëmit. Për rrjedhojë, kjo masë shpesh mbetet një opsion i pashfrytëzuar, pavarësisht potencialit të saj rehabilitues dhe pajtues.

*“Kjo masë shpesh has në vështirësi praktike, sepse shumë të mitur vijnë nga familje me kushte të vështira ekonomike, dhe dëmi nuk mund të kompensohet realisht, pavarësisht gatishmërisë për ta bërë këtë.” **Zyrtar Sprovues***

(M4) Vijimi i rregullt në shkollë		
Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë synon ri-integrimin arsimor dhe parandalimin e sjelljeve devijante tek i mituri që ka lënë shkollën apo nuk e ndjek rregullisht atë. Edhe pse KDM nuk përcakton kohëzgjatje të saktë, ajo zakonisht zgjat deri në fund të vitit shkollor ose derisa prokurori vlerëson se efekti i masës është arritur. Ajo duhet të shqiptohet për raste ku mos vijimi i shkollës lidhet me rreziqe sociale ose sjellje problematike. Shqyrtohet në bashkëpunim me shkollën dhe zbatohet në institucionin arsimor të fundit të ndjekur ose një tjetër të përshtatshëm, gjithnjë duke respektuar konfidencialitetin dhe interesin më të mirë të të miturit.	2023 5 Masa (3-M) (2-F)	Zbatimi i kësaj mase mbetet shumë i ulët krahasuar me potencialin që kjo masë ka në drejtim të rehabilitimit dhe parandalimit. Sipas profesionistëve të intervistuar, aplikimi i kësaj mase është penguar nga disa faktorë kyç. ▪ rastet ku shkolla nuk është më e gatshme të pranojë nxënësin për shkak të të 'kaluarës devijante' të tij apo saj, përbëjnë një pengesë praktike; ▪ shkollat nuk ka burime të mjaftueshme për të përkrahur të miturit me të 'kaluar delikuyente', sepse mungojnë psikologët, pedagogët apo personeli edukativ i specializuar për raste të tilla; ▪ në disa raste është vërejtur mungesë vullneti nga vetë të miturit apo familjet e tyre për të bashkëpunuar në këtë drejtim; ▪ i mituri refuzon të vazhdojë shkollimin në ndonjë shkollë tjetër përveç atje ku ka ndodhur vepra penale, ndërkohë që rikthimi në të njëjtën shkollë është i dëmshëm si për të miturin si kryerës, ashtu edhe për viktimën.
	2024 11 Masa (10-M) (1-F)	

"Për disa të mitur, kthimi në shkollë përmes kësaj mase mund të jetë i vështirë ose edhe joreal, sidomos nëse janë të përjashtuar, të përqeshur nga bashkëmoshatarët, apo nuk e kanë përfunduar arsimin fillor." **Zyrtar Sprovues**

&

"Ka raste kur shkolla heziton apo nuk bashkëpunon mjaftueshëm për ta kthyer të miturin në proces mësimor. Këto e bëjnë të vështirë zbatimin e kësaj mase. Kemi pasë raste kur është dashtë me intervenu nën kërcënimin e përpilimit kallëzimit penal ndaj menaxhmentit të shkollës për mos zbatim të vendimit për ekzekutim të masës. Ne nuk do të zmbresemi nga ekzekutimi dhe kthimi i të miturve në shkolla pavarësisht rezistencës nga personeli arsimor." **Prokuror për të Mitur**

&

"Kjo masë ka efekt të dyfishtë: i mituri rikthehet në përmbushjen e obligimeve të përditshme, por edhe jep sinjal se shoqëria i jep një shans të dytë. Institucionet arsimore duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë për të arritur qëllimin e plotë të kësaj mase." **Avokat**

(M5) Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Integrimi i të miturit në jetë profesionale përmes një angazhimi të përshtatshëm me aftësitë e tij. Kjo masë ndryshon nga puna me interes të përgjithshëm sepse është me pagesë dhe mund të jetë afatgjatë. Nuk është e detyrueshme dhe kërkon pëlqimin e të miturit. Ajo mund të zbatohet vetëm në përputhje me ligjet për punën dhe me standardet për mbrojtjen e fëmijëve. Aftësimi përfshin trajnime, kurse apo shkollim profesional, ndërsa vendimmarrja për llojin e punës ose aftësimit bëhet në konsultim me Shërbimin Sprovues dhe institucionet relevante. Kohëzgjatja nuk është e përcaktuar, por duhet të jetë e arsyeshme dhe e ndjekur nga prokurori përmes mbikëqyrjes.	2023 0 Masa (0-M) (0-F)	Të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë se kjo masë nuk është shqiptuar asnjëherë. Ky fakt është veçanërisht shqetësues, duke pasur parasysh që masa në fjalë synon rehabilitimin social dhe ekonomik të të miturve, veçanërisht atyre që nuk ndjekin shkollën ose nuk kanë mbështetje familjare të qëndrueshme. <i>Sipas profesionistëve të intervistuar, mos aplikimi i kësaj mase ndërlihet me disa faktorë:</i> ▪ papunësia e madhe në nivel të popullatës së përgjithshme e bën të vështirë gjetjen e mundësive për punësim të miturve; ▪ sektori privat nuk është i vetëdijshëm dhe as i përgatitur për të angazhuar të mitur me të kaluar penale; ▪ shumë të mitur vijnë nga familje me vështirësi financiare dhe sociale, dhe angazhimi në aftësim profesional krijon shpenzime si për udhëtim, materiale mësimore apo angazhim afatgjatë të cilat familja dhe SHSK nuk mundin ti mbulojnë.
	2024 0 Masa (0-M) (0-F)	Me gjithë sfidat ekzistuese, interpretimi aktual nga ana e profesionistëve nuk është i duhuri, pasi qëllimi përfundimtar i kësaj mase nuk është ‘punësimi’, por aftësimi i të miturit për një zanat apo profesion të caktuar, që do të ndikonte në zhvillimin e përgjegjshmërisë individuale, forcimin e ndjenjës së empatisë ndaj veprës së kryer, si dhe në përvetësimin e aftësive të nevojshme për jetën.

“Disa të mitur janë shumë të interesuar të mësojnë një zanat, por familjet nuk e përkrahin këtë drejtim, ata presin që i mituri të punojë menjëherë dhe të gjenerojë të ardhura financiare.” **Zyrtar Sprovues**

(M6) Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë synon të kontribuojë në riedukimin e të miturit dhe kompensimin e dëmit ndaj interesit të përgjithshëm të shkaktuar përmes veprës penale, duke mos pasur karakter ndëshkues dhe duke u shqiptuar vetëm me pëlqimin e të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Prokurori përcakton kohëzgjatjen, ndërsa Shërbimi Sprovues vendos për llojin e punës, institucionin përkatës dhe orarin. Puna duhet të jetë e lehtë, e përshtatshme për moshën dhe aftësitë e të miturit, dhe në funksion të interesit publik. Kohëzgjatja e masës duhet të jetë ndërmjet 10 dhe 60 orëve, me mundësi ndryshimi ose ndërprerjeje në rast të pengesave objektive gjatë ekzekutimit ose kur masa ka arritur qëllimin e vet.	2023 15 Masa (15-M) (0-F)	Kjo masë konsiderohet si një nga më të zbatuarat ndër të gjitha masat e diversitetit. Megjithatë, pavarësisht shqiptimit të shpeshtë dhe lehtësisë në zbatim, shqiptimi i saj mbetet ende modest në raport me potencialin rehabilitues që ofron. Sipas profesionistëve të intervistuar, veçanërisht prokurorëve për të mitur kjo masë vlerësohet si efikase në aspektin teknik të zbatimit, por shfaq dilema serioze në lidhje me ndikimin real në edukimin dhe rehabilitimin e të miturit. Disa nga rezervat e theksuara përfshijnë: ▪ rreziku i formalizimit të zbatimit, pra situata ku i mituri “figuron” se ka kryer punën e caktuar, por në realitet angazhimi i tij është minimal, jo i strukturuar apo nuk mbikëqyret siç duhet nga institucionet përkatëse. Kjo cenon vetë qëllimin edukues të masës dhe e redukton atë në një procedurë formale pa efekt të dukshëm; ▪ zgjedhja e llojit të punës nuk bazohet në analizë individuale, por shpesh bëhet automatikisht (si për shembull pastrimi i ambienteve publike), pa marrë parasysh interesat, aftësitë ose nevojat psikosociale të miturit.
	19 Masa (18-M) (1-F)	

“Ka raste kur komuniteti ose vetë institucionet lokale në fillim hezitojnë dhe nuk duan të përfshijnë të miturit në aktivitete, për shkak të paragjytimeve dhe frikës se ai apo ajo është delikuent. Mirëpo pas një kohe ata plotësisht ndërrojnë mendimin e tyre, duke parë aftësitë dhe përfshirjen e të miturve në punë dhe rezultatet konkrete”

Zyrtar Sprovues

(M7) Edukimi në rregullat e trafikut

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë ka për qëllim aftësimin e të miturit për rregullat e trafikut rrugor, dhe zhvillohet në auto-shkolla ose institucione të tjera përkatëse, duke përfshirë edukim teorik dhe praktik. Kjo masë është kryesisht e dedikuar për të miturit që kanë kryer vepra penale kundër sigurisë së trafikut rrugor, por mund të shqiptohet edhe për të mitur të tjerë për të parandaluar veprat e ngjashme dhe recidivizmin. Pas përfundimit të edukimit, i mituri vlerësohet nga profesionistë të kualifikuar, dhe Shërbimi Sprovues dërgon një raport mbi suksesin e tij. Kohëzgjatja e edukimit nuk është e caktuar paraprakisht dhe përshtatet me nevojat e të miturit, duke siguruar që nuk pengohet shkollimi ose aktivitetet e tjera të tij. Marrëveshja mes Shërbimit Sprovues dhe institucionit ofron mundësinë e edukimit, me kushtin e ruajtjes së konfidencialitetit, dhe parandalon çdo konflikt interesi mes profesionistëve të përfshirë.	2023 3 Masa (3-M) (0-F)	Nga të dhënat shihet se kjo masë sikurse masat e tjera është shumë pak e zbatuar. Sipas analizës dhe opinioneve të profesionistëve të intervistuar, disa nga pengesat kryesore në zbatimin efektiv të kësaj mase janë: ▪ numri i kufizuar i rasteve që përputhen me këtë masë, pasi ajo në mënyrë tipike aplikohet vetëm në vepra të lidhura me shkelje të rregullave të trafikut rrugor; ▪ mungesa e marrëveshjeve të qëndrueshme institucionale me auto shkolla apo institucione edukimi për trafik, që do të mundësonin ofrimin sistematik dhe të rregullt të edukimit; ▪ në shumë raste, këto bashkëpunime funksionojnë në baza ad-hoc dhe janë të varura nga disponueshmëria lokale dhe gatishmëria e palëve për të bashkëpunuar; ▪ kostoja financiare dhe mungesa e buxhetimit specifik për këtë masë, sidomos në raste kur nuk mund të ofrohet falas ose kërkohet pagesë për edukimin praktik. Kjo krijon pengesa për të miturit me gjendje të vështirë ekonomike, të cilët nuk mund të përballojnë trajnim të tillë.
	2024 4 Masa (4-M) (0-F)	

“Shumë të mitur që kryejnë vepra në trafik nuk kanë njohuritë bazë për sigurinë rrugore. Edukimi në këtë fushë është i nevojshëm për parandalim dhe vetëdijesim. Vetëdijesimi nuk është vetëm për të miturin, mirëpo edhe për prindërit dhe komunitetin për rëndësinë e edukimit dhe përfshirjes së të miturve në edukim të rregullt mbi trafikun.”

Prokuror për të Mitur

(M8) Këshillimi psikologjik		
Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë e obligon të miturin të vizitojë psikologun në intervale të caktuara kohore dhe të këshillohet me të për të adresuar sjelljet e tij që mund të kenë kontribuar në kryerjen e veprës penale. Kjo masë zhvillohet në një klinikë, ordinancë psikologu, ose vend tjetër të përshtatshëm, ku i mituri do të marrë këshilla për pjesëmarrje aktive në biseda dhe trajtime të tjera të përcaktuara nga psikologu. Masë mund t'i shqiptohet të miturve që kanë nevojë për këshillim për të parandaluar veprime të tjera penale dhe recidivizmin. Kohëzgjatja e këshillimit nuk është fikse, por përshtatet me nevojat e të miturit dhe vlerësohet nga psikologu. Shërbimi Sprovues dërgon raporte mbi përmbushjen e masës. Ekzekutimi i kësaj mase duhet të bëhet pa penguar shkollimin dhe aktivitetet e tjera të rëndësishme për të miturin. Për realizimin e kësaj mase, Shërbimi Sprovues duhet të ketë marrëveshje me psikologët e licencuar dhe të respektojë konfidencialitetin dhe parandalimin e konflikteve të interesit.	2023 41 Masa (36-M) (5-F)	Numri i masave të shqiptuara është relativisht i lartë krahasuar me masat e tjera të diversitetit, duke treguar një pranim të gjerë të kësaj mase si e rëndësishme dhe efektive. Në praktikë, masa zbatohet në bashkëpunim me psikologë të licencuar dhe ekzekutohet pranë institucioneve shëndetësore publike, përmes takimeve të rregullta që përcaktohen individualisht për secilin të mitur. Sipas profesionistëve të intervistuar, përkundër mundësive të shumta që ofron kjo masë ajo nuk është përdorur në masë të madhe pikërisht për shkak të kostos shumë të lartë financiare për të mbuluar pagesat e seancave për psikologët dhe shërbimet respektive. Po ashtu si sfidë janë identifikuar edhe vonesat në ekzekutimin e kësaj mase pranë institucioneve të shëndetit mendor. Përkundër sukseseve të shumta në aspektin e zbatimit të kësaj mase, në disa raste është theksuar mungesë cilësie në zbatimin e këshillimit psikologjik, kryesisht për shkak të numrit të kufizuar të seancave të ofruara për të miturin. Kjo përbën sfidë, pasi në shumë raste kërkohet trajtim përmes këshillimit afatgjatë, i cili përfshin një numër më të madh seancash.
	2024 41 Masa (37-M) (4-F)	

"Shpesh këshillimi psikologjik është hapi i parë për të kuptuar më drejt arsyet që e kanë çuar të miturin drejt konfliktit me ligjin dhe për të ndërtuar një plan për ndryshim dhe re integrim më të lehtë." **Zyrtar Sprovues**

&

"Në shumë raste, të miturit janë të gatshëm të përfshihen në këshillim, por sfida është të sigurosh mbështetje dhe vazhdimësi, sepse ndonjëherë mbarimi i programit ndodh shumë herët, pra i mitur ka nevojë për më tepër orë këshillimi apo seanca të cilat duhet të vazhdojnë në mënyrë që të arrijnë efektin e dëshiruar." **Prokuror për të Mitur**

(M9) Angazhimi në aktivitete bamirësie		
Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë kërkon angazhim në aktivitete bamirësie dhe është një mënyrë për të inkurajuar ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë qytetare tek i mituri që ka kryer një vepër penale. Kjo masë është veçanërisht e rëndësishme kur vepra ka prekur individë, grupe shoqërore ose komunitete, duke përfshirë ato që kanë nevojë për mbështetje si personat me aftësi të kufizuara ose të moshuarit. Angazhimi i të miturit në aktivitete bamirësie synon rritjen e empatisë dhe përgjegjësisë për veprimet e tij, duke kompensuar dëmet e krijuara dhe duke promovuar vlera si ndihma ndërsjellë dhe humanizmi. Kjo masë ngjan me punën pa pagesë në dobi të përgjithshme, por dallon për faktin se angazhimi është vullnetar dhe synon zhvillimin e përgjegjësisë civile dhe ndjenjës së keqardhjes. Masa jepet kryesisht në raste kur vepra penale ka pasur elemente të sjelljes antishoqërore dhe mungesës së empatisë, pavarësisht natyrës së lehtë të veprës.	2023 1 Masë (0-M) (1-F)	Fatkeqësisht edhe kjo masë sikurse masat e tjera risi në KDM nuk është shqiptuar pothuajse fare, me përjashtim të një rasti në vitin 2023. Prokurorët nuk e konsiderojnë këtë masë si prioritet, kryesisht për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme mbi efektet e saj pozitive në zhvillimin social dhe emocional të të miturve. Disa nga profesionistët e intervistuar nuk e shohin këtë masë, dhe as masat e tjera të reja të përfshira në KDM, si të efektshme apo të zbatueshme në praktikë.
	2024 0 Masa (0-M) (0-F)	Hezitimi për shqiptimin e kësaj mase lidhet gjithashtu me paragjykimin se ajo nuk mund të japë rezultate, pikërisht për shkak të mentalitetit tonë shoqëror në lidhje me përfshirjen në aktivitete bamirësie. Një tjetër arsye e theksuar për moszbatimin e kësaj mase ka të bëjë me mungesën e njohurive të sakta mbi qëllimin e saj dhe të masave të tjera të reja në kuadër të KDM-së. Deri më tani, nuk janë ofruar trajnimet e nevojshme për profesionistët në këtë drejtim.

“Edhe pse nuk e kemi zbatuar asnjëherë, megjithatë e konsiderojmë si pozitive veçanërisht kur të miturit përfshihen në aktivitete bamirësie, fillojnë të zhvillojnë empati, sepse e shohin jetën me një sy tjetër dhe marrin përgjegjësi më tepër. Besojmë në të ardhmen do të kemi në konsideratë shqiptimin më tepër të kësaj mase.” **Prokuror për të Mitur**

&

“Si avokat, e mbështes këtë masë sepse u jep të miturve mundësinë të reflektojnë për sjelljet e tyre pa u penalizuar rëndë. Në vend të dënimit, ata përfshihen në diçka që i mëson përgjegjësinë dhe ndjeshmërinë ndaj të tjerëve.” **Avokat**

(M10) Paga e një shume të caktuar të hollave të destinuar për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të miturit

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë ka për qëllim kompensimin e dëmit përmes pagesës dhe krijimin e mekanizmave për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale e të miturit, jo drejtpërdrejt për viktimën, por për komunitetin apo grupin e viktimave të caktuara. Dallimi me masën tjetër të kompensimit të dëmit është se kjo masë nuk përfshin kompensim të drejtpërdrejtë për individin e dëmtuar, por përmes një page që shkon për bamirësi apo për një program për kompensimin e viktimave. Masa mund të aplikohet edhe në rastet kur viktimat pajtohet që kompensimi të shkojë për bamirësi ose për programet e kompensimit të viktimave. Ky kompensim është vetëm në formën e pagesës monetare, pa mundësinë e zëvendësimit me punë praktike. Masa duhet të përputhet me gjendjen financiare të të miturit, në mënyrë që të mos rëndohet më tej situata e tij ekonomike. Gjithashtu, kjo masë synon të rrisë ndërgjegjësimin e të miturit për dëmin që ka shkaktuar dhe të krijojë një ndjenjë përgjegjësie ndaj shoqërisë dhe komunitetit.	2023 18 Masa (14-M) (4-F)	Në vitin 2023, kjo masë është shqiptuar gjithsej 18 herë, përkatësisht në 14 raste ndaj meshkujve dhe 4 raste ndaj femrave. Ndërsa në vitin 2024, zbatimi i kësaj mase ka shënuar rënie, duke u aplikuar në vetëm 13 raste, prej të cilave 12 ndaj meshkujve dhe vetëm 1 ndaj një femre.
	2024 13 Masa (12-M) (1-F)	Sipas profesionistëve të intervistuar, zbatimi i kësaj mase ka qenë relativisht i kufizuar dhe ka shënuar një tendencë në rënie nga viti 2023 në vitin 2024. Një arsye është vështirësia në përcaktimin dhe vlerësimin e situatës reale financiare të miturit, që është një kriter kyç për përshtatshmërinë e kësaj mase. Gjithashtu, fakti që kjo masë nuk përfshin mundësinë e zëvendësimit me punë praktike mund të kufizojë përdorimin e saj në rastet ku pagimi i shumës monetare nuk është i realizueshëm.

“Është e rëndësishme që pagesa për bamirësi apo kompensim të mos përjetohet si ndëshkim financiar, por si pjesë e procesit të reflektimit dhe drejtësisë restauruese.”

Zyrtar Sprovues

(M11) Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë ka për qëllim të plotësojë dhe mbushë aktivitetet e përditshme të të miturit me angazhime të shëndetshme, duke parandaluar boshllëqet që mund të çojnë në sjellje të padëshiruara dhe në kryerjen e veprave penale. Kjo masë synon uljen e sjelljeve negative dhe ngritjen e përgjegjësisë të të miturit, duke i ofruar mundësinë për të zhvilluar shprehje pozitive dhe duke kontribuar në modelimin e sjelljeve të shëndetshme. Edhe pse mund të duket si një masë argëtuese, angazhimi në aktivitete sportive kërkon përgjegjshmëri dhe vullnet, cilësi të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e vetëkontrollit dhe disiplinës tek të miturit. Kjo masë gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në drejtësinë restauruese, duke u fokusuar në riparimin e marrëdhënieve dhe përmirësimin e mirëqenies së të miturit, duke ofruar mundësinë për ta nxitur atë në një angazhim të shëndetshëm dhe pozitiv.	2023 1 Masë (0-M) (1-F)	Kjo masë është zbatuar vetëm një herë në vitin 2023 dhe vetëm një herë në vitin 2024. Sipas profesionistëve të intervistuar, përdorimi i kësaj mase mbetet dukshëm i ulët, me vetëm dy raste të zbatuara në periudhën dyvjeçare të analizuar. Ky nivel i ulët i zbatimit ngre shqetësime mbi njohjen dhe vlerësimin e potencialit rehabilitues të kësaj mase nga autoritetet përkatëse. Mungesa e strukturave të mirë organizuara për aktivitete sportive apo mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional me organizata të sportit dhe rekreacionit mund të jenë faktorë që e kufizojnë zbatimin praktik të saj.
	2024 1 Masë (1-M) (0-F)	Ashtu si edhe në rastin e masave të tjera të reja, edhe për këtë masë është evidentuar mungesa e njohurive të duhura lidhur me qëllimin e saj, gjë që në masë të madhe lidhet me mungesën e trajnimeve të posaçme për profesionistët përkatës.

"Edhe pse fatkeqësisht qenka zbatuar 2 herë deri më tani, prapëseprapë e konsideroj si një prej masave më pozitive. Ajo ndihmon në shkarkimin e energjisë negative, përfshirjen sociale të të miturit, largimin nga rrugët dhe ndërtimin e lidhjeve me bashkëmoshatarët." **Psikolog Klinik**

&

"Unë do ta kisha propozuar në rend të parë këtë si masë diversiteti për ato raste kur ishin plotësuar kushtet për shqiptimin e saj. Në vend që të ndëshkohen, të miturit kanë nevojë të kanalizojnë kohën e lirë në mënyrë konstruktive. Sporti është një mënyrë ideale për këtë." **Avokat**

(M12) Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Masa e diversitetit që përfshin familjet ka një natyrë të veçantë dhe më të gjerë, pasi ajo përfshin jo vetëm të miturin kryerës, por edhe anëtarë të tjerë të familjes, duke shpërndarë detyrimet që lidhen me zbatimin e masës. Pavarësisht se detyron të miturin të angazhohet në një veprim konkret, zbatimi i saj shpesh kërkon bashkëpunimin dhe angazhimin e familjes, duke bërë që kjo masë të dalë përtej mundësive individuale të të miturit. Në një kuptim më të ngushtë, kjo masë mund të shihet si një teknikë për arritjen e pajtimit mes familjeve të përfshira, duke riparuar marrëdhëniet e cenuara që mund të kenë shkaktuar konfliktin. Kjo është e rëndësishme pasi nëse marrëdhëniet familjare nuk trajtohen dhe riparohen, mund të shërbejnë si një faktor që çon në përqendrimin e situatës dhe eskalimin e konfliktit. Përfshirja e familjeve është veçanërisht e nevojshme në raste kur anëtarët e familjes janë përfshirë indirekt në veprën penale, si p.sh. kur të miturit kanë përdorur sharje dhe fyerje ndaj njëritjetrit, apo kur ata jetojnë pranë njëritjetrit dhe marrëdhëniet familjare kanë ndikuar në sjelljen e të miturit. Në këto raste, masa e diversitetit synon të krijojë një bazë më të gjerë për riparimin e marrëdhënieve, duke përfshirë edhe familjet e të miturve, dhe duke i mundësuar atyre të kontribuojnë në zgjidhjen e konfliktit dhe përmirësimin e situatës.	2023 0 Masa (0-M) (0-F)	Zbatimi i kësaj mase në vetëm dy raste gjatë vitit 2024 dhe mungesa totale e saj në vitin paraprak tregon se ajo është fare pak e përdorur, pavarësisht potencialit të saj për të ndikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse në rehabilitimin e të miturve. Në rrethanat kur veprat penale kryhen nga të miturit, pasojat nuk prekin vetëm të miturin si kryerës dhe viktimën, por shpeshherë edhe familjet e tyre. Në këtë kontekst, mos shqiptimi i kësaj mase, e cila synon trajtimin dhe rehabilitimin afatgjatë të të miturve, paraqet një shqetësim serioz.
	2024 2 Masa (0-M) (2-F)	Argumenti i mungesës së njohurive lidhur me qëllimin e masës nuk përbën justifikim të mjaftueshëm për moszbatimin e saj. Përkundrazi, kjo nxjerr në pah nevojën urgjente për ndërhyrje sistematike në ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe promovimin e qasjes së rehabilitimit në drejtësinë për të mitur.

“Edhe pse nuk kam pas asnjë masë në ekzekutim, konsideroj që kjo masë është shumë e dobishme sidomos kur konflikti mes të miturit dhe viktimës ka përfshirë edhe tensione ndërmjet familjeve. Këshillimi ndihmon në uljen e konfliktit dhe ndërtimin e mirëkuptimit.” Zyrtar Sprovues

&

“Përfshirja e familjeve në proces jo vetëm që rrit efektivitetin e masës, por edhe ndihmon që mesazhi për përgjegjësi dhe pajtim të përçohet në një mjedis më të gjerë social.” Psikolog Klinik

(M13) Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë konsiston në ndalimin e të miturit për të takuar individë të caktuar, ka një funksion të qartë mbrojtës dhe parandalues. Ajo synon të ndërpresë ndikimin negativ që një person tjetër, shpesh më i madh në moshë ose me sjellje devijante, mund të ketë ushtruar mbi të miturin, duke ndikuar në përfshirjen e tij në veprën penale. Përmasë kësaj mase, i mituri angazhohet të mos krijojë më kontakte me një apo më shumë persona konkretë, të cilët identifikohen si faktorë rreziku për sjelljen e tij. Zbatimi i saj kërkon që prokurori në aktvendim të përshkruajë qartë identitetin e personave që i ndalohet të miturit t'i takojë, në mënyrë që masa të ketë efekt praktik dhe të jetë e monitorueshme në mënyrë më të qartë nga institucionet përkatëse. Megjithatë, suksesi i kësaj mase varet kryesisht nga vetëdijesimi i të miturit dhe nga mbështetja që ai merr për të kuptuar pasojat e kontaktit me individët e caktuar. Kjo është një arsye pse kjo masë mund të shoqërohet me masa të tjera ndihmëse, si këshillimi psikologjik apo angazhimi në aktivitete që rrisin vetëkontrollin dhe pavarësinë e të miturit nga ndikimet negative.	2023 2 Masa (2-M) (0-F)	Rritja e ndjeshmë e zbatimit të kësaj mase nga viti 2023 në vitin 2024. Megjithatë, sipas profesionistëve sfida mbetet monitorimi efektiv i ndalimit të kontaktit dhe sigurimi që masa të mos mbetet vetëm formale. Monitorimi dhe kontrolli në praktikë është edhe më i vështirë nëse i mituri nuk ka më kontakte me individin e përmendur, sidomos në komunitete të vogla ku kontaktet janë të pashmangshme (fshatra, lagje, shkolla të njëjta). Kjo sfida bëhet edhe me serioze kur nuk shoqërohet me masa të tjera si këshillimi psikologjik, apo ndonjë masë tjetër që do të mbështeste zvogëlimin e ndikimit të personave apo shoqërisë së caktuar tek i mituri. Përveç sfidave të lartcekura, shqetësues është edhe fakti se një pjesë e profesionistëve të intervistuar nuk e konsiderojnë këtë masë si veçanërisht efektive, jo për shkak të qëllimit të saj thelbësor rehabilitues, por për shkak të mungesës së mundësive reale përta monitoruar dhe ndjekur zbatimin e saj në praktikë. Pa një sistem të qartë dhe të funksional të ndjekjes dhe vlerësimit të progresit të miturit gjatë periudhës së zbatimit të masës, profesionistët ndihen të pafuqishëm për të garantuar që kjo masë arrin efektin e saj rehabilitues. Ky perceptim i kufizuar i efikasitetit është një pengesë shtesë për shqiptimin e masës, duke rrezikuar që ajo të mbetet një instrument i nën shfrytëzuar, pavarësisht potencialit të tij për të ndikuar pozitivisht në ri integrimin social të miturit.
	2024 14 Masa (11-M) (3-F)	

"Në disa raste, ndikimi i shoqërisë apo rrethit të gabuar ka qenë faktor kryesor në përfshirjen e të miturit në vepra penale. Prandaj e kam pa të arsyeshme që nëpërmjet kësaj mase të ndikohet tek i mituri për ti ndërprerë kontaktet me individë të caktuar, si një hap i domosdoshëm drejt rehabilitimit." **Prokuror për të Mitur** &

"Shumë të mitur nuk e kuptojnë ndikimin e rrethit shoqëror në zgjedhjet e tyre. Kjo masë ndihmon për t'i ndërgjegjësuar dhe për t'i nxitur të ndajnë rrugët me ata që i shtyjnë drejt veprimeve negative." **Zyrtar Sprovues**

(M14) Të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Edhe kjo masë ka funksion mbrojtës dhe parandalues, duke synuar të kufizojë ekspozimin e të miturit ndaj mjediseve me ndikim negativ që mund të nxisin sjellje të dëmshme apo të paligjshme. Zotimi për të mos frekuentuar vende të caktuara (si lokale, klube nate, ambiente ku ka përdorim të substancave, apo kinema me përmbajtje të papërshtatshme) është mënyrë për të mbrojtur të miturin nga kontaktet me persona ose situata që mund të ndikojnë në sjelljen e tij. Shqiptimi i kësaj mase shpesh bazohet në vendin ku është kryer vepra penale, apo në njohuri të tjera për zakonet e të miturit që lidhen me frekuentimin e këtyre mjediseve. Këto informacione mund të dalin gjatë intervistimit të të miturit apo nga pranimet e tij lidhur me rrethanat e ngjarjes. Sfidë kryesore në zbatimin e kësaj mase është mungesa e mekanizmave praktikë për mbikëqyrjen e përditshme, gjë që mund ta bëjë të miturin të mendojë se pasojat e mos përmbajtjes janë minimale. Prandaj, për efektshmëri, kjo masë duhet të shoqërohet me angazhim të prindërve, mbikëqyrësve apo shërbimeve sociale, dhe sidomos me punë ndërgjegjësimi për të miturin rreth pasojave të kontaktit me mjedise të rrezikshme.	2023 0 Masa (0-M) (0-F)	Në bazë të dhënave vërehet një rritje e ndjeshme në zbatimin e saj nga 0 raste në vitin 2023 në 21 raste në vitin 2024. Profesionistët e intervistuar, kanë theksuar të njëjtat sfida dhe gjetjet janë të njëjta sikur të Masa 13 (shih më lart).
	2024 21 Masa (16-M) (5-F)	

“Shqiptimi i kësaj mase kërkon vlerësim të kujdesshëm të realitetit të miturit, nuk mund të kërkojë që të mos shkojë në një vend që është pjesë e jetës së përditshme, pa ofruar një zgjidhje reale dhe që e përmbush atë boshllëk.” Avokat

&

“Kjo masë ka kuptim dhe do të ekzekutohet me sukses vetëm nëse zbatohet si pjesë e një plani më të gjerë për rehabilitim dhe përfshirje sociale. Ndryshe, rrezikon të shihet thjesht si ndalim dhe jo si ndihmë. Shërbimi Sprovues duhet të gjejë alternative në mënyrë që i mituri mos të ndiej mungesën e vizitës në objektin apo lokalin e caktuar negativ” Prokuror për të Mitur

(M15) Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Kjo masë diversiteti synon të parandalojë rikthimin e të miturit në sjellje devijante përmes zotimit të tij për të mos përdorur drogë apo alkool, veçanërisht në rastet kur këto substanca kanë ndikuar drejtpërdrejt në kryerjen e veprës penale. Ajo ka natyrë mbrojtëse dhe funksionon si një premtim personal, por zbatimi efektiv i saj kërkon ndërgjegjësim të lartë nga i mituri dhe shpesh është i vështirë për t'u monitoruar. Për këtë arsye, rekomandohet që kjo masë të kombinohet me këshillim psikologjik apo edhe me masa tjera mbështetëse si p.sh.: mos kontaktimi me individë negativë dhe mos frekuentimi i vendeve të rrezikshme, për të qenë efektive dhe me ndikim afatgjatë si dhe me qëllim përforcimin e ndikimit pozitiv.	2023 10 Masa (9-M) (1-F)	Numri i masave të shqiptuara është për të lavdëruar, për faktin që shqiptimi i kësaj mase në aspektin praktik është i vështirë. Kjo për faktin e mungesës të provave të qarta që përdorimi i substancave ka qenë i lidhur me veprën penale. Profesionistët e intervistuar theksojnë si sfida që vetëm zotimi për të mos përdorur substanca është shpesh i pamjaftueshëm, sidomos për të mitur me histori më të thellë përdorimi ose me probleme sociale/psikologjike. Në mungesë të këshillimit psikologjik, mbështetjes familjare apo mentorimit, masa mbetet formale dhe me ndikim të kufizuar.
	2024 6 Masa (6-M) (0-F)	Një sfidë shtesë serioze në zbatimin e kësaj mase mbetet mungesa e programeve adekuate të trajtimit dhe rehabilitimit për këta të mitur. Por, edhe në rastet kur ekzistojnë programe të tilla, ato shpesh janë të kufizuara në kapacitet, të shtrenjta e që kërkojnë angazhim afatgjatë dhe ndërhyrje të integruara nga profesionistë të shëndetit mendor, çka nënkupton se zbatimi efektiv i masës varet nga një infrastrukturë dhe resurse që aktualisht mungojnë ose janë të pamjaftueshme. Në mungesë të këtyre kapaciteteve, masa shpesh shihet nga profesionistët si jo realiste e zbatueshme, duke çuar në shmangien e saj, pavarësisht qëllimit të saj rehabilitues dhe preventiv. Kjo situatë e bën veçanërisht të rrezikshëm mos shqiptimin e masës, pasi të miturit përdorues të substancave shpesh kanë nevojë për ndërhyrje të specializuara në një fazë të hershme për të parandaluar përshkallëzimin e problemeve të tyre shëndetësore dhe sociale.

“Si avokat, e mbështes këtë masë kur ka indikacione të qarta për ndikimin e substancave. Por gjithmonë do të mbështesja dhe kushtëzoja me nevojën për ofrim të qasjes rehabilituese, jo vetëm ndëshkuese. Pra, për realizim me sukses do të duhej një program i mirëfilltë rehabilitues afatgjatë për zbehjen dhe largimin e ndikimit të substancave” **Avokat**

&

“Përmbajtja nga substancat është themel për çdo përpjekje rehabilituese. Por për të qenë efektive, masa duhet të shoqërohet me mbështetje të rregullt psikologjike dhe ndonjëherë edhe përfshirje të qendrave të trajtimit. Prandaj, Shërbimi Sprovues duhet të punoj në këto dy drejtime për të qenë masa e suksesshme.” **Prokuror për të Mitur**

&

“Kemi raste kur të miturit nuk e shohin përdorimin e alkoolit apo kanabisit si problem. Kjo masë mund të jetë pikënisje për reflektim dhe ndërgjegjësim. Mirëpo ne si shërbim kemi vështirësi në ekzekutim të kësaj mase, për shkak që rehabilitimi kërkon programe dhe trajtim që është afatgjatë dhe shumë i kushtueshëm, e fatkeqësisht ne nuk kemi programe dhe mundësi financiare për ta mbuluar rehabilitimin” **Zyrtar Sprovues**

(M16) Vërejtja policore

Çka është synuar!	Sa është zbatuar?	Gjetjet aktuale
Masa e diversitetit e vërejtjes policore përfaqëson një nga risitë më domethënëse të reformës së fundit ligjore në drejtësinë për të mitur në Kosovë, e cila synon të ofrojë një reagim të shpejtë, proporcional dhe joformal ndaj rasteve kur një i mitur kryen për herë të parë një veprë penale të lehtë. Kjo masë e veçantë nuk kërkon iniciimin e procedurës penale të zakonshme dhe mundëson që ndërhyrja të bëhet në fazat më të hershme të kontaktit të të miturit me sistemin e drejtësisë, duke ndihmuar kështu në parandalimin e stigmës, rikthimit në sjellje delinkuente dhe ekspozimit ndaj institucioneve të drejtësisë penale. E vetmja nga masat e diversitetit që zbatohet nga policia, vërejtja policore kushtëzohet me miratimin paraprak të prokurorit, i cili garanton kontrollin ligjor dhe respektimin e të drejtave të të miturit. Që kjo masë të zbatohet, duhet të plotësohen dy kushte: që vepra të jetë e lehtë dhe të jetë kryer për herë të parë, duke reflektuar kështu frymën e trajtimit edukativ dhe jo ndëshkues të të miturve, veçanërisht atyre që përfshihen aksidentalisht në sjellje të dënueshme. Kjo qasje e bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, forcon parimet e drejtësisë restauruese dhe synon t'i japë të miturit një mundësi reale për reflektim dhe ri përfshirje pozitive në shoqëri pa i ngarkuar atij një dosje penale.	2023 0 Masa (0-M) (0-F)	Megjithëse masa e vërejtjes policore u shoqërua me pritshmëri të larta dhe u konsiderua si një hap i rëndësishëm drejt avancimit të zbatimit të masave të diversitetit, duke ofruar një alternativë të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë për trajtimin e rasteve të lehta, zbatimi i saj ka rezultuar jashtëzakonisht zhgënjyes. Kjo masë, që synonte të siguronte një ndërhyrje të hershme, joformale dhe proporcionale në rastet kur i mituri për herë të parë përfshihet në një veprë penale të lehtë, është shqiptuar vetëm 4 ose 5 raste nga viti 2019. Mungesa e shqiptimit në praktikë përfaqëson një dështim të konsiderueshëm në realizimin e synimeve të reformës ligjore dhe nxjerr në pah një hendek të madh midis objektivave të sistemit dhe realitetit në terren. Sipas profesionistëve të përfshirë në fushën e drejtësisë për të mitur, ekzistojnë disa arsye kyçe që kanë penguar zbatimin e kësaj mase. Ndër to përfshihen: • frika nga reagimi publik dhe keqkuptimi i mundshëm rreth natyrës jo-ndëshkuese të kësaj mase; • mospajtimet dhe debatet e vazhdueshme ndërmjet policisë dhe prokurorisë lidhur me mandatin dhe mënyrën e shqiptimit të masës; • mungesa e protokolleve, udhëzimeve standarde dhe dokumentacionit praktik (duke përfshirë edhe format e shkresave), të cilat do t'i udhëzonin zyrtarët policor në mënyrë të qartë dhe të unifikuar; • mungesa e përfshirjes së kësaj mase në data bazën e Policisë së Kosovës, pamundësia për regjistrimin e saj në sistemin; • frika nga mundësia e keqpërdorimit në rastet kur diskrecioni i prokurorit delegohet tek policia. Gjatë vitit të fundit janë bërë përpjekje të konsiderueshme për ta kapërcyer këtë situatë. Një hap pozitiv ka qenë përgatitja dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit, përmes të cilit saktësohen dhe ndahen qartë përgjegjësitë dhe rolet e policisë dhe të prokurorisë në lidhje me shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase. Ky zhvillim pritët të krijojë kushte më të favorshme për zbatimin e masës së vërejtjes policore në të ardhmen e afër.
	2024 0 Masa (0-M) (0-F)	

*“Edhe pas kaq shumë viteve kjo masë fatkeqësisht nuk është duke u zbatuar edhe pse shpesh dhe në shumë raste ka mundur të zgjidhej nëpërmjet kësaj mase. Mungesa e koordinimit midis policisë dhe prokurorisë për vërejtjet policore tregon që sistemi nuk është i përgatitur për të trajtuar seriozisht rastet me të mitur, dhe kjo duhet të ndryshojë urgjentisht.” **Avokat***

&

*“Unë si prokurore kam qenë e gatshme të caktoj këtë masë, mirëpo kemi pritë që Prokuroria e Shtetit të zhvilloj një qarkore ose ndonjë udhëzues standard në mënyrë që të unifikohet praktika e punës në të gjitha prokuroritë.” **Prokuror për të Mitur***

&

*“Shumë raste kanë mundur të zgjidheshin nëpërmjet vërejtjes policore, mirëpo ne nuk kemi pasë autoritet dhe mundësi për të tejkaluar kompetencat që i ka dhënë KDM prokurorit për të mitur, i cili ka fjalën përfundimtare në aspektin e caktimit të masës.” **Polici***

3.1.2. Të gjeturat e përmbledhura

Grupi i dytë i të gjeturave ofron një përmbledhje të praktikave, sfidave dhe pengesave që ndikojnë në zbatimin e masave të diversitetit në nivelin e përgjithshëm, duke identifikuar faktorët që mund të kufizojnë efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij mekanizmi alternativ.

Sfidat dhe pengesat

Zbatimi në praktikë i masave të diversitetit ka nxjerrë në pah një sërë sfidash dhe pengesash të rëndësishme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e tyre të qëndrueshëm, të barabartë dhe të unifikuar në të gjitha hallkat e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur:

- **Rënie e vazhdueshme e numrit të masave të diversitetit të shqiptuara:** Të dhënat tregojnë një trend negativ në përdorimin e masave të diversitetit, çka bie ndesh me frymën dhe synimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM);
- **Mospërputhje ndërinstitucionale në zbatimin e masave:** Ekzistojnë dallime të mëdha në mënyrën e shqiptimit të masave të diversitetit ndërmjet Prokurorisë Themelore. Mungesa e një qasjeje të harmonizuar dhe standardizuar ka krijuar një praktikë të pabarabartë dhe fragmentare në të gjithë vendin;
- **Përfshirja e të miturve në vepra të rënda penale:** Një nga arsyet kryesore që është theksuar përse nuk po shqiptohen masat e diversitetit lidhet me rritjen e përfshirjes së të miturve në vepra të rënda penale, të cilat tejkalojnë kriteret për aplikimin e këtyre masave. Megjithatë, kjo arsye nuk ka mundur të verifikohet në mënyrë të besueshme për shkak të mungesës së të dhënave të kategorizuara sipas llojit të veprës penale;

- **Mungesë e kuptimit të drejtë të masave të diversitetit:** Zbatuesit e KDM, veçanërisht në nivel të prokurorisë, nuk e kanë të qartë plotësisht qëllimin e masave të diversitetit siç është përcaktuar në KDM, duke rezultuar në një interpretim dhe zbatim të ndryshëm të dispozitave përkatëse, sidomos me aspektet e procedurës;
- **Moszbatim i masave të reja të parapara në KDM:** Masat e diversitetit të përfshira rishtazi në Kodin e Drejtësisë për të Mitur nuk janë duke u zbatuar në praktikë, për shkak të mungesës së njohurive për qëllimin e atyre masave, hezitimit të prokurorëve për t'i përdorur ato, apo edhe mungesës së shërbimeve konkrete për ti ekzekutuar ato në përputhje me qëllimin e përcaktuar në KDM;
- **Dallime ndërmjet të dhënave, si dhe mungesa e të dhënave të kategorizuara:** është evidentuar mungesa e të dhënave të kategorizuara sipas kriterëve të rëndësishme si moshë, gjinia, lloji i veprës dhe aspekte tjera statusore. Për më tepër, në disa raste, të dhënat që ekzistojnë nuk përputhen ndërmjet burimeve të ndryshme, duke vështirësuar analizën dhe monitorimin e saktë të situatës;
- **Mungesa e përfshirjes në parandalim:** Rritja e rasteve të përfshirjes së fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale, veçanërisht në grup moshën 12 deri në 14 vjeç, në vepra penale të rënda përbën një shqetësim serioz. Ky fenomen është një nga arsyet pse, kur këta fëmijë arrijnë moshën e përgjegjësisë penale, nuk plotësojnë kriteret për zbatimin e masave të diversitetit. Në shumë raste, ndërhyrja ndodh tepër vonë, kur fëmija është tashmë i përfshirë në disa vepra të rënda penale, çka e kufizon mundësinë për shmangie nga ndjekja penale dhe trajtim përmes alternativave rehabilituese;
- **Mungesë zbatimi të U.A për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale:** Megjithatë Udhëzimi Administrativ për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale ka hyrë në fuqi në vitin 2021, zbatimi i tij në praktikë mbetet i mangët. Një pjesë e profesionistëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë dhe të mbrojtjes së fëmijëve ose nuk janë të informuar për ekzistencën e këtij akti nënligjor, ose nuk e zbatojnë atë në mënyrë konsistente dhe të plotë;
- **Mungesa e informatave kthyes:** Prokuroria dhe, në disa raste, edhe gjykatat nuk sigurojnë komunikim kthyes të rregullt dhe në kohë lidhur me vendimet që marrin për rastet ku të miturit janë të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale tek shërbimi sprovues, qendra për punë sociale dhe policia;

- **Ofrimi i programeve të vazhdueshme edukative:** Përkundër ekzistimit të programeve edukuese dhe trajnuese për Shërbimin Sprovues, viteve të fundit vërehet një stagnim në ofrimin e trajnimeve të rregullta pranë Akademisë për Siguri Publike;
- **Mungesa e trajnimeve të përbashkëta:** Mungesa e trajnimeve të përbashkëta ka ndikuar në zbehjen e bashkëpunimit dhe unifikimit të praktikës së punës për policinë, shërbimi sprovues, prokurorinë, avokatët dhe profesionistët tjerë;
- **Bashkëpunimi ndër sektorial i zbehtë:** Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet Policisë, Prokurorisë dhe Shërbimit Sprovues shpesh paraqitet si efektiv, në praktikë ai vuan nga mungesa e koordinimit substancial dhe të orientuar drejt fëmijës. Bashkëpunimi ende bazohet kryesisht në veprime burokratike dhe formale, dhe jo në parimin thelbësor të “fëmijës në qendër” apo në zbatimin e veprimeve të përbashkëta, të shpejta dhe të koordinuara, që do të mundësonin shmangien reale të miturit nga procedurat formale të drejtësisë;
- **Konfuzion ndërmjet ndërmjetësisimit dhe masave të diversitetit:** Ekziston një moskuptim i qartë lidhur me dallimin ndërmjet tri masave të para të diversitetit, të cilat janë të bazuara në procedurën e ndërmjetësisimit, dhe procedurave të tjera alternative;
- **Mungesa e stafit të mjaftueshëm:** Në disa prokurori, ekziston vetëm një prokuror i caktuar për çështjet që lidhen me të miturit, dhe për shkak të volumit të lartë të rasteve, shpesh është e vështirë të menaxhohet në mënyrë të duhur e gjithë procedura ndaj tyre. Një situatë e ngjashme vërehet edhe në Shërbimin Sprovues, ku një numër zyrtarësh sprovues janë pensionuar, transferuar në institucione të tjera apo kanë emigruar jashtë vendit, pa u zëvendësuar me staf të ri. Kjo mungesë e kapaciteteve njerëzore veçanërisht tek SHSK ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e zbatimit të programeve për ekzekutimin e masave të diversitetit. Kjo ka krijuar një vakum institucional, i cili ka reduktuar ndjeshëm aftësinë për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje efektive për të miturit gjatë periudhës së referimit apo gjatë ndjekjes së programeve alternative ndaj ndjekjes penale;
- **Mospërputhja ndërmjet kuadrit ligjor dhe sistemit të menaxhimit të rasteve:** Ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet dispozitave procedurale që rregullojnë shqiptimin e masave të diversitetit dhe funksionaliteteve të sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve (SMIL). Kjo krijon vështirësi në regjistrimin e saktë dhe ndjekjen sistematike të masave të shqiptuara, duke ndikuar negativisht në monitorimin dhe raportimin institucional;

- **Mungesa e kushteve dhe burimeve për ekzekutim të masave:** Zbatimi i disa prej masave të diversitetit kërkon resurse specifike financiare dhe logjistike, të cilat shpesh mungojnë. Mos ndarja e buxhetit të nevojshëm për Shërbimin Sprovues rrezikon seriozisht zbatimin efektiv të masave të diversitetit, duke pamundësuar ofrimin e shërbimeve mbështetëse për të miturit në konflikt me ligjin. Kjo përfshin masa që ndërlidhen me masat: (këshillimin psikologjik, edukimin në rregullat e trafikut, punën në dobi të përgjithshme, përfshirjen në programe të aftësimit profesional, rehabilitimi nga varësia e substancave psikotrope dhe alkooli etj).

Praktikat e mira dhe ndikimi

Përkundër sfidave të shumta në zbatimin dhe shqiptimin e masave të diversitetit, praktika ka dëshmuar se këto masa mund të kenë ndikim të prekshëm dhe afatgjatë pozitiv në jetën e të miturve, kur ato aplikohen në mënyrë të duhur dhe mbështeten nga programe rehabilituese efektive. Në disa raste të dokumentuara:

- Të miturit **kanë përfituar nga programet e aftësimit profesional**, duke fituar shkathtësi që u kanë mundësuar të integrohen në mënyrë të qëndrueshme në tregun e punës pas përfundimit të masës;
- Një rast konkret përfshin një të mitur që, pas përfundimit të masës së diversitetit dhe trajnimit profesional, **ka gjetur punë të rregullt** dhe është përfshirë në aktivitet ekonomik;
- Në një tjetër rast, një i mitur me probleme të theksuara të sjelljes, falë kombinimit të këshillimit psikologjik, mbështetjes familjare dhe përfshirjes në një program edukativ dhe profesional, **ka arritur të përfundojë shkollimin** dhe të realizojë integrim të suksesshëm në shoqëri dhe në tregun e punës.

Këto raste të suksesshme dëshmojnë se masat e diversitetit, kur shoqërohen me mbështetje të mirë strukturuar dhe ndërhyrje të koordinuara, përbëjnë një alternativë efektive dhe humane ndaj ndjekjes penale, duke kontribuar në rehabilitimin e të miturve dhe uljen e recidivizmit.

Tregim sukcesi:

- *Inicialet e të miturit: E.K.*
- *Vendbanimi: Prishtinë*
- *Mosha në kohën e masës: 16 vjeç*
- *Gjinia: Mashkull*
- *Statusi shkollor: Nxënës i klasës së X-të*
- *Vepra penale: Vjedhje e rëndë*

Vlerësimi fillestar:

Gjatë anketës sociale të zhvilluar nga Shërbimi Sprovues u identifikua se i mituri ishte përdorues i rregullt i marihuanës dhe aktet e vjedhjes i kishte kryer për të siguruar këtë substancë. Po ashtu u konstatua mungesë mbështetjeje emocionale në familje dhe përfshirje në një rreth shoqëror me ndikim negativ.

Masa e rekomanduar dhe qëllimi:

Shërbimi Sprovues para prokurorit për të mitur rekomandoi masën e diversitetit të këshillimit psikologjik si formë ndërhyrjeje jo-përgjashtuese, me qëllim adresimin e varësive të hershme, çështjeve emocionale dhe përmirësimit të funksionimit psiko-social të miturit.

Procesi i zbatimit:

- *I mituri është përfshirë në 12 seanca individuale me psikologun.*
- *Seancat janë ndërtuar mbi teknika të terapisë kognitive-biheviorale (CBT) dhe qasjes se intervistës motivuese për të rritur vetëdijen e tij për pasojat dhe për të nxitur ndryshim të qëndrueshëm.*
- *Fillimisht, E.K. shfaqte mungesë të reflektimit, justifikim të sjelljeve dhe distancim emocional.*
- *Gjatë seancave, ai filloi të artikulojë ndjenjat e tij të braktisjes dhe mungesës së përkrahjes prindërore çka u identifikua si një faktor rrënjësor në sjelljen e tij problematike.*
- *U punua në zhvillimin e aftësive për menaxhimin e impulseve, refuzimin e presionit nga bashkëmoshatarët dhe ndërtimin e vetëbesimit.*

Rezultatet dhe ndikimi:

- *I mituri raportoi se nuk kishte më dëshirë të përdorte marihuanë duke u ndjerë më i "pastër në mendje" dhe më i përfshirë në aktivitetet e përditshme.*
- *Filloi të ndjekë rregullisht mësimet dhe mori vlerësime më të mira nga mësimdhënësit.*
- *Mësoj të shprehë nevojat dhe frustrimet pa dhunë apo arratisje duke zhvilluar forma të reja të komunikimit me prindërit.*
- *Nuk ka pasur asnjë rast të ri penal dhe kontakti i tij me Shërbimin Sprovues është mbyllur pozitivisht.*

'Ky rast ilustron fuqishëm se si masat e diversitetit, kur kombinohen me ndërhyrje profesionale psikologjike dhe mbështetje të koordinuar ndërinstitucionale, mund të ndryshojnë rrjedhën e jetës së një të mituri. Ato krijojnë mundësi reale për rehabilitim dhe rikthejnë të miturin drejt një integrimi të qëndrueshëm në familje, shkollë dhe shoqëri.'

3.2. Konkluzion

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale, në thelb të kërkesave të tyre për ndërtimin e një sistemi efikas të drejtësisë për të mitur, **e theksojnë rëndësinë e masave të diversitetit si një ndër mënyrat kryesore për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve** kur të miturit janë në konflikt me ligjin. Promovimi dhe zbatimi i këtyre masave përbën një imperativ që duhet të integrohet në sistemet e brendshme të drejtësisë të çdo shteti.

Në përputhje me këto instrumente, edhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, në Komentin e Përgjithshëm nr. 10¹⁵, thekson se një sistem i drejtësisë për të mitur që respekton Konventën për të Drejtat e Fëmijës **duhet të promovojë në mënyrë aktive përdorimin e masave të diversitetit**. Një sistem i tillë jo vetëm që mbron interesin më të mirë të miturve në konflikt me ligjin, por gjithashtu kontribuon në interesin më të gjerë afatshkurtër dhe afatgjatë të shoqërisë në tërësi.

Bazuar në vlerësimin e realizuar, mund të konstatohet se sistemi i drejtësisë për të mitur në Kosovë, **në përgjithësi dhe në një masë të konsiderueshme, është i harmonizuar me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare**, duke ofruar një bazë të qëndrueshme për zbatimin praktik të parimit të “interetit më të mirë të fëmijës” përmes masave të diversitetit.

Sistemi i ndërtuar mbi bazën e Kodit të Drejtësisë për të Mitur **promovon në mënyrë aktive përdorimin e masave të diversitetit si një mjet për të shmangur procedurat penale formale** ndaj të miturve. Kodi parasheh një gamë të gjerë masash të diversitetit, të cilat mund të zbatohen në faza të ndryshme të procedurës penale, duke filluar nga momenti i parë i kontaktit të të miturit me policinë, si dhe gjatë fazës së hetimeve të udhëhequra nga prokuroria.

Megjithatë, pavarësisht përparimeve në ndërtimin e këtij sistemi, vlerësimi ka identifikuar se **zbatimi praktik i këtyre masave mbetet i kufizuar dhe nuk përputhet plotësisht** me synimet e ligjvënësit dhe standardet ndërkombëtare.

Adresimi i këtyre sfidave është thelbësor për të garantuar që dispozitat përkatëse të Kodit të Drejtësisë për të Mitur që lidhen me masat e diversitetit të mos mbesin vetëm në letër, por të zbatohen realisht dhe në mënyrë efektive. **Krijimi i mundësive të reja, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ofrimi i shërbimeve të bazuara në nevojat e profesionistëve dhe vetë të miturve** janë elemente kyçe për të siguruar që sistemi i drejtësisë për të mitur në Kosovë të përputhet plotësisht me standardet për të drejtat e njeriut dhe të garantojë mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin.

¹⁵ Komenti i Përgjithshëm nr. 10 i KDF-së, paragrafi 3.

Për të mbështetur zbatimin e të gjeturave të identifikuara, **vlerësimi përmban një sërë rekomandimesh** që synojnë të ndihmojnë institucionet e drejtësisë, dhe jo vetëm ato, në forcimin e zbatimit të sistemit të drejtësisë për të mitur dhe në sigurimin që ky sistem të ofrojë mbrojtjen e synuar për fëmijët, përmes një zbatimi efikas të masave të diversitetit.

3.3. Rekomandime

Me qëllim adresimin e sfidave dhe pengesave të evidentuara, rekomandohet ndërmarra e masave të mëposhtme për të siguruar një zbatim më të efektshëm, të drejtë dhe të qëndrueshëm të masave të diversitetit:

Rekomandimet afatshkurta:

- **Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture:** Këshilli Prokuorial të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për emërimin e prokurorëve për të mitur me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore brenda Departamenteve për të Mitur në kuadër të Prokurorive Themelore. Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për rekrutimin e zyrtarëve sprovues të rinj dhe të sigurohen që këta zyrtarë pranojnë trajnimet e nevojshme bazike dhe të avancuara mbi rolin dhe obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi;
- **Hartimin e një qarkoreje juridike ose opinionit ligjor:** Zyra e Prokurorit të Shtetit duhet të hartojë një qarkore juridike që adreson qartë interpretimin e dispozitave të reja të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), me qëllim unifikimin e praktikës në të gjitha Prokuroritë Themelore. Shpërndarja e këtij dokumenti në të gjitha prokuroritë dhe organizimi i punëtorive gjithëpërfshirëse me prokurorët për të mitur dhe bashkëpunëtorët profesionalë për diskutimin e interpretimeve të ndryshme dhe ndarjen e përvojave praktike;
- **Sigurimi i kushteve për ekzekutimin e masave në praktikë:** Ministria e Drejtësisë duhet të planifikojë dhe ndajë SHSK-së burimet e nevojshme financiare dhe logjistike për mbështetjen e masave që kërkojnë angazhim të drejtpërdrejtë, si këshillimi psikologjik, edukimi në rregullat e trafikut, puna në dobi të përgjithshme, aftësimi profesional apo masave tjera;
- **Unifikimi i praktikës në nivel kombëtar:** Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit të mbajë trajnime dhe hartojë udhëzues të standardizuar për shqiptimin dhe zbatimin e masave të diversitetit në të gjitha Prokuroritë Themelore, me qëllim eliminimin e qasjes jo unifikuese dhe rritjen e koherencës në vendimmarrje;

- **Zbatimi i të gjitha masave të përcaktuara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur:** Policia në koordinim me Prokurorët për të mitur të ndërmarrin hapa për promovimin dhe shqiptimin e “vërejtjes policore”, duke fuqizuar zbatimin praktik të Procedurës Standarde të Veprimit për shqiptimin e vërejtjes policore dhe trajnime për policët të cilët do të zbatojnë këto masa. Po ashtu, prokurorët për të mitur duhet të marrin rolin koordinues dhe të organizojnë takime të rregullta me shërbimin sprovues dhe policinë me qëllim zbatimin e të gjithave masave në mënyrë efikase dhe të shpejtë;
- **Programet e aftësimit profesional dhe punësimi:** Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të promovuar dhe lehtësuar përfshirjen e të miturve që janë subjekt i masave të diversitetit në programet ekzistuese të aftësimit profesional, të ofruara në kuadër të Qendrave të Aftësimit Profesional (QAP). Po ashtu, këto dy ministri duhet të zhvillojnë dialog të strukturuar me Odat Ekonomike dhe sektorin privat, me qëllim që të identifikohen mundësitë për aftësim profesional të orientuar drejt tregut të punës dhe punësim të qëndrueshëm për të miturit, duke reduktuar kështu stigmën dhe duke kontribuar në integrimin e tyre të plotë shoqëror dhe ekonomik;
- **Realizimi ex-post i Kodit të Drejtësisë për të Mitur:** Ministria e Drejtësisë të realizojë vlerësimin e zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me theks të veçantë, kapitujt që rregullojnë mbrojtjen e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale, atë mbi masat e diversitetit dhe kapitullin mbi aspektet procedurale për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë. Ky vlerësim është thelbësor për të kuptuar më saktë nëse është i nevojshëm amandamentimi i KDM;
- **Ofrimi i shërbimeve të specializuara parandaluese:** Institucionet duhet të ndërmarrin hapa urgjent për ofrimin e shërbimeve parandaluese dhe të rrisin numrin e profesionistëve mbështetës në shkollë dhe Qendra për Punë Sociale, për fëmijët para moshës së përgjegjësisë penale;
- **Organizimi i debatit kombëtar mbi moshën e përgjegjësisë penale dhe sjelljet devijante të fëmijëve:** Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante të drejtësisë për të mitur, si dhe aktorë nga niveli akademik, shoqëria civile, mediat dhe ekspertë të fushës, duhet të organizojë një debat kombëtar të strukturuar mbi temën: *“Përfshirja e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale në kryerjen e veprave penale të rënda”* Në kuadër të këtij debati duhet të trajtohen edhe çështje të tjera të ndërlidhura, përfshirë: a) Nivelin alarmues të përfshirjes së fëmijëve në sjellje devijante, veçanërisht në grup moshat 10–14 vjeç; b) Ndikimin e moshës aktuale të përgjegjësisë penale

në efektivitetin e masave parandaluese dhe rehabilituese; c) Intervenimet e mundshme institucionale, sociale dhe ligjore për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse këtë fenomen në rritje;

- **Dërgimi i informatave kthyesë në mënyrë të rregullt:** Pavarësisht llojit të vendimit, qoftë ai mos fillim i hetimeve, pushim i procedurës, zbatim i një mase diversiteti apo dërgim i rastit në gjykim, është thelbësore që këto vendime t'u dërgohen në kohë dhe në mënyrë të strukturuar institucioneve të përfshira në sistemin e drejtësisë për të mitur, siç janë Shërbimi Sprovues, Qendrat për Punë Sociale dhe Policia. Mungesa e këtyre informatave ndikon negativisht në vazhdimësinë dhe koherencën e veprimeve mbështetëse e monitoruese, si dhe e zbeh bashkëpunimin ndërinstitucional, duke penguar funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë me në qendër fëmijën;
- **Harmonizimi i sistemit SMIL me dispozitat ligjore:** Prokuroria e Shtetit të përmirësojë dhe rifreskojë funksionalitetin e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve (SMIL), në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me kërkesat procedurale për regjistrimin e rasteve si të përfunduara, me theks te veçantë ato që ndërlidhen me parimin e oportunitetit, pushimin e procedurës dhe pezullimin, si dhe të gjitha këto ti njihen në aspektin e normës së punës së prokurorit për të mitur.

Rekomandimet afat mesme dhe afat gjata:

- **Zhvillimi i një hulumtimi gjithëpërfshirës mbi delikuencën e të miturve:** Ministria e Drejtësisë, në partneritet me universitetet dhe institucionet kërkimore vendore, duhet të ndërmarrë një studim kombëtar gjithëpërfshirës lidhur me delikuencën e të miturve në Republikën e Kosovës. Ky hulumtim duhet të synojë: a) përmasat dhe trendët e përfshirjes së të miturve në vepra penale; b) profilin socio-demografik të të miturve që kryejnë vepra penale (mosha, gjinia, statusi shkollor, familjar, ekonomik, etj.); c) Llojet më të shpeshta të veprave penale të kryera nga të miturit dhe moshat kur ato ndodhin më shpesh; d) Faktorët dhe shkaqet që ndikojnë në sjelljen devijante; e) analizën e masave të marra deri tani, efektivitetin e tyre dhe boshllëqet në sistemin aktual të drejtësisë për të mitur;
- **Përmirësimi i njohurive të aktorëve të drejtësisë për të mitur:** Të organizohen seri trajnimesh individuale dhe të përbashkëta me prokurorë, policë dhe zyrtarë sprovues, për qëllimin, filozofinë dhe dispozitat ligjore që rregullojnë masat e diversitetit dhe drejtësinë restauruese;

- **Sigurimi i edukimit të vazhdueshëm:** Shërbimi Sprovues duhet të ndërmarrë hapa konkretë për të filluar organizimin e edukimit të vazhdueshëm profesional për zyrtarët sprovues në bashkëpunim me Akademinë për Siguri Publike në Vushtri. Ky program trajnimi duhet të jetë obligativ për të gjithë zyrtarët sprovues dhe të përfshijë në mënyrë të veçantë aspektet që ndërlidhen me zbatimin e masave të diversitetit, si dhe me mbikëqyrjen dhe përkrahjen e të miturve gjatë periudhës së ekzekutimit të masave. Po ashtu, Akademia e Drejtësisë duhet të organizojë trajnime të rregullta dhe të strukturuar për prokurorët, profesionistët tjerë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për të mitur, me fokus të veçantë në zbatimin praktik të masave të diversitetit;
- **Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional:** Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Shtetit dhe Policia duhet të bashkëpunojnë dhe të mbështesin nivelin lokal me qëllim fuqizimin e koordinimit ndërmjet prokurorëve për të mitur, zyrtarëve sprovues dhe policëve për të mbështetur ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e masave të diversitetit, në mënyrë që zbatimi të jetë gjithëpërfshirës dhe në interesin më të mirë të fëmijës;
- **Forcimi i ndërmjetësimit si mekanizëm i drejtësisë restauruese:** Ministria e Drejtësisë së bashku me Odën e Ndërmjetësve duhet të zhvillojë programe për fuqizimin e kapaciteteve të ndërmjetësve, në përputhje me kërkesat e KDM-së, dhe të adresohen keqkuptimet lidhur me nevojën për licenca të specializuara, përmes fushatave informuese dhe trajnimeve të synuara.

IV. SHTOJCA

4.1. Burimet e referencave

Instrumentet ndërkombëtare, protokolle, strategji, libra, studime dhe raporte

- Protokollu shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale (Vendimi i Qeverisë nr. 11/109, datë 23.11.2022).
- Kartelat e Raportit KOMF për kujdesin ndaj fëmijëve (2023, 2024).
- Vlerësimi i mbështetjes së BE-së për drejtësinë për të mitur në Kosovë (Raport përfundimtar 2018).
- Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijës në Kosovë (UNICEF, 2014).
- Strategjia për Mbrojtjen e Fëmijëve 2021–2030 (UNICEF).
- Reimagine Justice for Children (UNICEF, 2021).
- Vlerësimi i sistemeve administrative të të dhënave për drejtësinë për fëmijët (UNICEF, 2021).
- Qasja e barabartë e fëmijëve në drejtësi – Evropa Qendrore dhe Lindore (UNICEF, 2015).
- Strategjia Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale (2018–2022).
- Standardet Minimale për Shërbimet Sociale (Standardet 1, 2, 3, 6 dhe 13).
- Hartimi dhe Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Kosovë (Zyra e Kryeministrit, 2012).
- Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën (2016–2024).
- Kompensimi i viktimave të dhunës në familje (Instituti i Kosovës për Drejtësi & CLARD, 2023).
- Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunës seksuale nga sistemi i drejtësisë në Kosovë (EULEX, 2022).
- Raportet e EULEX për Monitorimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (2021–2024).
- Drejtësi e orientuar drejt fëmijës – Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës ndaj fëmijëve në sistemet e drejtësisë për fëmijë (PRI, TDH, AIMJF, 2025).
- African Charter on Human and Peoples' Rights, 27 June 1981, CAB/LEG/67/3 rev. 5, 21 I.L.M. 58 (1982).
- Cappelaere, G., Grandjean, A., Naqvi, Y., *Children Deprived of Liberty: Rights and Realities*, Editions Jeunesse et Droit, 2005.

- Children's Legal Centre and United Nations Children's Fund, 'Administrative Detention of Children: A Global Report', New York, 2011.
- Cipriani, D., 'Children's Rights and the Minimum Age of Criminal Responsibility: A Global Perspective', Ashgate, 2009.
- Ellison, Louise, 'Cross-examination and the intermediary: bridging the language divide?', *Criminal Law Review*, 114, 118, 2002.
- Inter-Parliamentary Union and United Nations Children's Fund, 'Child Protection: A handbook for Parliamentarians, Inter-Parliamentary Union, No. 7', Geneva, 2004.
- Johnstone, G., 'Restorative Justice: Ideas, Values, Debates', 2002.
- Klaus, J.F., Handbook on Probation Services: Guidelines for Probation Practitioners and Managers, United Nations.
- Morris, A. and Maxwell, G., 'Restorative Justice in New Zealand: Family Group Conferences as a Case Study', *Eastern Criminology Review*, 1998.
- F. Ross, M. P. Togliatti, *Perspectives on Children's Testimony*, New York: Springer Verlag, 1989.
- Seymour, J., *Dealing with Young Offenders*, The Law Book Company, Sydney, 1988.
- United Nations.
- United Nations Office on Drugs and Crime, Model Law on Juvenile Justice, 2011.
- United Nations Office on Drugs and Crime and UN-Habitat, 'Crime Prevention Assessment Tool', United Nations, New York, 2009.

Legjislacioni vendor

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (Ligji nr. 06/L-084)
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi nr. 06/L-006)
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L-074) dhe Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal nr. 06/L-074
- Kodi i Procedurës Penale (Kodi nr. 08/L-032) dhe Ligji nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 08/L-032
- Ligji për Familjen (Ligji nr. 2004/32)
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr. 08/L-255)
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (Ligji nr. 08/L-185)
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (Ligji nr. 04/L-218)

- Rregullorja (QKR) nr. 18/2024 për përcaktimin e procedurave efektive për identifikimin, raportimin dhe referimin e shfrytëzimit, neglizhencës dhe abuzimit ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 03/2024 për bashkëpunimin e strukturave dhe mekanizmeve institucionale me OJQ-të për zbatimin e politikave të të drejtave dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve
- Rregullorja (QKR) nr. 07/2024 për organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve
- Rregullorja (QKR) nr. 23/2023 për procedurat e punës në tryezat shumë disiplinore për ndihmë në menaxhimin e rasteve
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2023 për përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse për të ndaluar pjesëmarrjen e fëmijëve në klube nate dhe hapësira të ngjashme
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 05/2023 për masat për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me drogë
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2023 për trajtimin mjekësor dhe psikologjik të fëmijëve viktimë të abuzimit, për rehabilitim dhe ri-integrim
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 08/2022 për Këshillin për të Drejtat e Fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 07/2022 për autoritetet për të drejtat e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2022 për masa për mbrojtjen e fëmijëve nga faqet e internetit me përmbajtje pornografike dhe që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë miqësore për fëmijët në procedurat penale, civile dhe administrative.

Instrumentet Ndërkombëtare:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR), 1950
- Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual
- Protokollin Opsional i KDF mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë
- Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë

- Direktiva 2012/29/BE për standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit
- Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave
- Direktiva 2016/800/BE për garancitë procedurale për fëmijët që janë të dyshuar ose të akuzuar
- Strategjia e BE për të Drejtat e Fëmijëve (2021–2024)
- Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësi Miqësore për Fëmijët (2010)
- Rekomandimi CM/Rec (2018)7 për të drejtat e fëmijëve në ambientin digjital
- Rekomandimi CM/Rec (2012)2 për pjesëmarrjen e fëmijëve nën 18 vjeç
- Rekomandimi CM/Rec (2011)12 për të drejtat e fëmijëve dhe shërbime sociale miqësore
- Udhëzime për kujdes shëndetësor miqësor për fëmijët (2011)
- Rekomandimi CM/Rec (2009)10 për strategji të integruara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna
- Rekomandimi R (98)8 për pjesëmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe shoqërore
- Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (Nr. 1, 5, 6, 8, 10, 12)
- Rezoluta 2002/12 mbi Parimet Themelore për përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese në çështje penale

4.2. Lista e profesionistëve të intervistuar, takimet e zhvilluara dhe grupet fokusit

Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni
1. Anita Kalanderi	Sekretare e Përgjithshme Ministria e Drejtësisë
2. Blerim Shabani	Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare Ministria e Drejtësisë
3. Qëndresa Ibra-Zariqi	Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Fëmijës Zyra e Kryeministrit Zyra për Qeverisje të Mirë
4. Adnan Isufi	Gjyqtar për të Mitur Gjykata Themelore Prishtinë
5. Lumnije Krasniqi	Gjyqtare për të Mitur Gjykata Themelore Prishtinë
6. Sahit Boroci	Gjyqtar për të Mitur Gjykata Themelore Gjilan
7. Mimoza Shala	Prokurore për të Mitur Prokuroria Themelore në Prishtinë
8. Rabije Jakupi	Prokurore për të Mitur Prokuroria Themelore Gjilan
9. Isuf Sadiku	Prokuror i Shtetit Prokuroria Themelore në Gjilan
10. Ramadan Ahmeti	Drejtor i Policisë në Bashkësi Policia e Kosovës
11. Luljeta Limani Sylejmani	Drejtor Parandalimi dhe Hetimi i Dhunës në Familje Policia e Kosovës
12. Sami Hajrullahu	Divizionit për Masa Alternative, Shërbimi Sprovues
13. Fusharza Kelmendi	Udhëheqëse e Lirimit me Kusht Shërbimi Sprovues

14. Gentiana Pira	Zyrtare e Lartë për të Mitur Shërbimi Sprovues
15. Hirmize Halimi	Udhëheqëse e Zyrës Gjilan Shërbimi Sprovues
16. Llukman Mehmeti	Zyrtar Sprovues Shërbimi Sprovues Gjilan
17. Ebasan Sadiku	Zyrtar Sprovues Shërbimi Sprovues Gjilan
18. Emine Sadiku	Asistente Administrative Shërbimi Sprovues Gjilan
19. Yll Zekaj	Avokat me seli në Prishtinë
20. Sherif Sherifi	Avokat me seli në Gjilan
21. Abaz Gjigolli	U.D Asociaconi i Qendrave për Punë Sociale
22. Mursel Zymberi	Drejtor Qendra për Punë Sociale në Gjilan
23. Makfirete Shamolli	Drejtor Qendra për Punë Sociale Lipjan
24. Amir Bushi	Drejtor Qendra për Punë Sociale Hani i Elezit
25. Arrita Dervishi	Zyrtare e Shërbimeve Sociale Qendra për Punë Sociale Gjakovë
26. Berlina Dushi	Zyrtare e Shërbimeve Sociale Qendra për Punë Sociale Gjakovë
27. Afërdita Kçiku	Psikologe Klinike QKMF Gjilan
29. Dren Rexha	Specialist i Politikave Sociale UNICEF
30. Feride Dashi	Zyrtare për Mbrojtjen e Fëmijëve UNICEF

31. Donjeta Kelmendi	Drejtoreshë Ekzekutive KOMF
32. Klevis Vaqari	Menaxhere e Programit KOMF
33. Fjolla Hoxha	Menaxher e Programit të Drejtësisë TDH

4.3. Përkufizime

Përkufizimet e përdorura në këtë vlerësim do të interpretohen sipas kuptimeve të dhëna në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacionin tjetër përkatës në Republikën e Kosovës.

Fëmijë	nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai/ajo i nënshtrohet. Në rastet kur mosha e personit nuk është përcaktuar plotësisht, por ka arsye që lënë të nënkuptohet se personi në fjalë është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj deri në përcaktimin e plotë të moshës së tij.
I mitur	nënkupton fëmijën mes moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
Prind	nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.
Përgjegjësia prindërore	nënkupton obligimin e prindit për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte me fëmijën dhe obligimin për t'i siguruar fëmijës mirërritjen, prindërimin, edukimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.
Kujdestar	nënkupton personin siç është përcaktuar në Ligjin për familjen.
Mbrojtja e fëmijës	nënkupton parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtepisë.
Mbrojtës i viktimës	nënkupton personin zyrtar publik, i cili përfaqëson palën e dëmtuar në procedura gjyqësore dhe administrative, përfshirë edhe fëmijën. Mbrojtësi i viktimës u ofron mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit, përfaqëson viktimën në procedura para gjykatës, njofton viktimën për të drejtat e tij, përfaqëson interesat e viktimës para gjykatës dhe prokurorisë, si dhe vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme në përputhje me ligjet në fuqi.
Drejtësi miqësore ndaj fëmijës	nënkupton sistemin e drejtësisë që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, konsideratë mbizotëruese është interesi më i mirë i fëmijës, mos diskriminimi, mbrojtja e dinjitetit dhe pjesëmarrja e fëmijës duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje	nënkupton personin nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht nga zotësia për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës ose ndonjë veprimtarie kriminale, si dhe individit nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet për kryerjen e një vepre penale dhe fëmijët në konflikt me ligjin.
Fëmija pa përkujdesje prindërore	nënkupton fëmijën, prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur, prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror.
Familje në nevojë	nënkupton çdo familje, kur njërit ose të dy prindërve, kujdestarit dhe përkujdesësit, u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit/ërve ose kujdestarit të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve, apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuatë, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë.
Përfaqësues ligjor	nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.
Dhunë	nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës. Dhuna përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo çon në dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.
Dhunë psikologjike	nënkupton aktet të cilat shkaktojnë ose kanë të ngjarë të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi i cili ka përgjegjësi, është i besuar ose ka pushtet dhe përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jo fizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues.

Dhunë fizike	nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytit dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike.
Abuzim	nënkupton çdo veprim apo mosveprim, të qëllimshëm apo jo, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoritetit, që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës.
Keqtrajtim	Nënkupton të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues, apo shfrytëzimin komercial, ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim real ose potencial për shëndetin, mbijetesën, zhvillimin ose dinjitetin e fëmijës në kontekstin e një raporti të përgjegjësisë, besimit apo pushtetit.
Prostitucion me fëmijë	nënkupton përdorimin e fëmijës për veprimtari seksuale, ku në këmbim të përfshirjes në veprimtari seksuale të fëmijës ofrohen ose premtohen si pagesë para ose çdo formë tjetër shpërblimi ose kompensimi, pavarësisht nëse ajo pagesë, ai premtim ose shpërblim i bëhet fëmijës ose një pale të tretë.
Trafikimi i fëmijës	nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin, marrjen e fëmijëve për qëllime shfrytëzimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës, apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme, ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.
Shfrytëzim	përfshin por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, pornografisë ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.
Abuzimi seksual i fëmijës	nënkupton shprehjen e abuzimit brenda shtëpisë ose familjes, por nuk përjashton edhe rastet e abuzimit nga persona jashtë familjes duke përdorur përparësitë e pozitës qoftë sociale apo edhe zyrtare për përfitime seksuale nga viktimat e abuzimit. Aktiviteti seksual i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër.

